



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 192

Tiranë – E Premte, 19 Dhjetor 2014

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 8842, datë 9.12.2014	Për një ndryshim në dekretin nr. 8766, datë 31.10.2014 “Për dhënie të shtetësisë shqiptare” 10693
Dekret i Presidentit nr. 8843, datë 12.12.2014	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 10693
Dekret i Presidentit nr. 8844, datë 15.12.2014	Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore..... 10693
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 857, datë 10.12.2014	Për miratimin e “Profilit të zgjeruar të Migracionit për vitin 2013” 10694
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit nr. 5177/9, datë 2.12.2014	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit “Rikonstruksion i sheshit të Xhamisë Kubelike dhe rikonstruksion i Rrugës së Tironsave” 10749
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 7529, datë 11.12.2014	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By-Pass Fier (kultura bujqësore dhe drufrutore)” 10750

**DEKRET****Nr. 8842, datë 9.12.2014****PËR NJË NDRYSHIM NË DEKRETIN
NR. 8766, DATË 31.10.2014 "PËR DHËNIE
TË SHTETËSISË SHQIPTARE"**

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës së Shqipërisë,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Ndryshimin e pikës 2 të nenit 1 të dekretit nr. 8766, datë 31.10.2014 "Për dhënie të shtetësisë shqiptare" nga "Jana (Yana) Vladimir Mataj (Buldjajeva)" në "Jana (Yana) Vladimir Mataj (Buldjaeva)".

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

DEKRET**Nr. 8843, datë 12.12.2014****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Almida Maringlen Çelmeta (Zera)
2. Erisa Eduard Çelmeta
3. Dion Eduard Çelmeta
4. Alketa Simion Vaso
5. Argeta Xhemali Murati
6. Vojislava Bogo Krstović
7. Denis Fidelino Halo
8. Artur Xhafer Xhaferraj
9. Sonila Petraq Xhaferraj (Proko)

10. Iris Fejzi Shabani
11. Deshire Qazim Domi (Bermuça)
12. Besim Halil Kulheku
13. Teuta Ramazan Kulheku (Thermija)
14. Kelmend Besim Kulheku
15. Jora Besim Kulheku
16. Elona Xhelal Kurtbegu
17. Eduard Tahir Titini
18. Marjel Tonin Demaj
19. Alfred Palë Vuksani
20. Shkëlqim Han Tusha
21. Beqir Malë Prengezi
22. Kleand Mitat Haxhiaj
23. Teuta Bajram Göddel (Haxhiaj)
24. Fabian Sihat Muço
25. Shkëlqim Adem Lushaj
26. Jetmir Maksut Eisemann (Pasha)
27. Nesila Saimir Çela
28. Barbara Ilir Dymi
29. Mimoza Jonuz Marku
30. Angela Fari Xhediku

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

DEKRET**Nr. 8844, datë 15.12.2014****PËR CAKTIMIN E DATËS SË
ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja "gj" dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 9, paragrafit 1 dhe 2 dhe nenit 10, paragrafët 1 dhe 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të zhvillohen ditën e diel, më datë 21 qershor 2015.



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 857, datë 10.12.2014

**PËR MIRATIMIN E "PROFILIT TË
ZGJERUAR TË MIGRACIONIT PËR
VITIN 2013"**

Në zbatim të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 141, të ligjit nr. 108/2013, "Për të huajt", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e "Profilit të zgjeruar të Migracionit për vitin 2013", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Statistikave për publikimin e "Profilit të zgjeruar të migracionit për vitin 2013" në faqet zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**PROFILI I ZGJERUAR I
MIGRACIONIT
2013**

Ky dokument prezanton Profilin e Zgjeruar të Migracionit në Republikën e Shqipërisë të vitit 2013. Hartimi dhe publikimi i tij është mbështetur në pikën 4, të nenit 141, të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt". Informacioni i mbledhur dhe analiza e të dhënave për përgatitje e këtij Profili është siguruar nga burime zyrtare. Profili i zgjeruar i Migracionit i viti 2013 i miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. --- datë--- gjendet i publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Ministrave, si dhe të institucioneve përgjegjëse për hartimin e tij. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij dokumenti nuk mund të riprodhohet, kopjohet apo transmetohet në asnjë formë apo mënyrë elektronike apo mekanike, duke përfshirë fotokopjen, regjistrimin pa të drejtën e autorëve. Materiali është publikuar me mbështetjen e Qeverisë Shqiptare. Përmbytja e këtij publikimi është përgjegjësi e Grupit të Punës, të ngritur me Urdhër të Ministrit të Punëve të Brendshme, nr. 239, datë 15.7.2014.

Hartimi dhe publikimi i Profilit të zgjeruar të Migracionit, i viti 2013 është financuar nga Qeveria Shqiptare.

Në hartimin e këtij Profilit të zgjeruar mbi Migracionin dhanë kontribut ONM, zyra e UNHCR në Tiranë, Prezenca e OSBE-së në Tiranë dhe ICMPD.



Ministria e Punëve të Brendshme



Departamenti për Kufirin dhe Migracionin



Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinise



Ministria e Punëve të Jashtme



Ministria e Financës



Ministria e Zhvillimit Ekonomik,
Tregtisë dhe Sipërmarrjes



Instituti i Statistikës



Ministria e Arsimit dhe e Sportit



Ministria e Shëndetësisë

INFORMACION I PËRGJITHSHËM¹

Kryeqyteti: Tiranë

Sipërfaqja: E përgjithshme: 28,748 km² (tokë: 27,398 km²; ujë: 1,350 km²)

Kufiri: Gjatësia e përgjithshme: 1079 km (tokësor: 717 km; detar: 362 km)

Shtetet kufitare: Mali i Zi 151 km, Kosovë 112 km, Maqedoni 172 km, Greqia 282 km

Popullsia: Popullsia shqiptare e regjistruar sipas Regjistrimit të Gjendjes Civile: 4 329 326

Popullsia shqiptare sipas INSTAT²: 2 898 782; dendësia: 100.8/km²

Gjuha: Gjuha zyrtare në Shqipëri është gjuha shqipe. Në territoret e banuara nga minoritetet përveç gjuhës shqipe flitet dhe gjuha greke, serbo-kroate dhe maqedonase.

Presidenti: Bujar Nishani

Kryeministri: Sali Berisha³; Edi Rama⁴

Qeverisja: Republikë parlamentare

Hyrje

Migracioni vazhdon të përbëjë një aspekt të rëndësishëm të marrëdhënieve të Republikës së Shqipërisë me vendet fqinje, vendet anëtare të Bashkimit Evropian e më gjerë, si dhe një angazhim serioz në kuadër të përpjekjeve të Shqipërisë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian.

Menaxhimi i flukseve migratore, fokusuar kryesisht në hartimin dhe përditësimin e profileve të migracionit, është jo vetëm një tregues i menaxhimit bashkëkohor të migracionit, por dhe një kontribut në informimin publik mbi situatën migratore në vend.

Profilin e zgjeruar të Migracionit në vitin 2010, i hartuar sipas modeleve më të avancuara dhe të unifikuara jo vetëm në vendet e BE-së, por dhe më gjerë nga një grup pune ndërinstitucional dhe në bashkëpunim me struktura të tjera që kontribuojnë në fushën e migracionit në Shqipëri, si ato qeveritare dhe joqeveritare, shënon fillimin e menaxhimit bashkëkohor të flukseve migratore në Shqipëri nga

¹ Harta: CIA World Facts Book https://www.cia.gov/library/publications/the-worldfactbook/maps/maptemplate_al.html

² CENSUS i vitit 2011

³ Deri në datën 11.9.2013

⁴ Nga data 11.9.2013, sipas dekretit të Presidentit të Republikës nr. 8304, datë 11.9.2014

strukturat përgjegjëse.

Profili i zgjeruar mbi Migracionin i vitit 2013 synon të paraqesë situatën migratore në periudhë relevante njëvjeçare, pavarësisht materialeve analitike mbi migracionin, të cilat, në varësi të flukseve migratore apo ndryshimeve të situatave migratore, mund të jenë përgatitur dhe publikuar dhe për periudha me të shkurtra kohore.

Përgatitja e Profilit të zgjeruar mbi Migracionin përmban në vetvete jo vetëm të dhëna statistikore, por një analizë të gjithanshme të situatës migratore.

Të dhënat e përfituara nga CENSUS-i i vitit 2011 në Shqipëri, kanë shërbyer si një ndër burimet kryesore të informacionit për fusha të ndryshme me ndikim në situatën migratore në vend.

Profili i zgjeruar i Migracionit i vitit 2013, krahas të tjerash, do të përmbajë të dhëna statistikore të vitit 2013, por të krahasuara me ato që nga viti 2010 e në vazhdim.

Pjesa A e Profilit të zgjeruar të Migracionit synon të përshkruajë se si ka evoluar migracioni gjatë viteve. Për më tepër, ai jep një përmbledhje të shkurtër të trendeve dhe çështjeve kryesore në dekadën e fundit, por me karakteristikë në tri vitet e fundit periudhe, kjo në mes Profilit të vitit 2010 dhe këtij Profili. Pjesa B jep një pasqyrë të kushteve socio-ekonomike të vendit, në mënyrë për të kuptuar faktorët e mundshëm shtytës dhe tërheqës që ndikojnë të migracioni. Pjesa C analizon nga njëra anë modelet e migracionit dhe trendët më të fundit dhe nga ana tjetër siguron një pasqyrë të të dhënave ekzistuese të numrit dhe tipave të imigrantëve/emigrantëve të rregullt, imigrantëve/emigrantëve të parregullt, informacion lidhur me diasporën jashtë, si dhe remitancat (dërgesat). Pjesa C, gjithashtu, identifikon të dhënat e munguara.

Bazuar në të dhënat e pjesëve A, B dhe C, pjesa D përmbledh në formën e një analize, trendet kryesore të migracionit, duke përcaktuar faktorët kryesorë shtytës dhe tërheqës që kanë ndikuar mbi migracionin për periudhën së cilës i referohet ky Profil. Për më tepër, është hulumtuar mbi lidhjen ndërmjet faktorëve të ndryshëm demografikë dhe socio-ekonomikë dhe ndikimet e tyre të migracionit, në zhvillimin social-ekonomik dhe në efektivitetin e politikave të migracionit të lidhura me to.

Gjetjet dhe analizat kryesore janë prezantuar në pjesën H të këtij profili. Në pjesën H tregohen mangësitë e të dhënave ekzistuese dhe strategjitë e mundshme për përmirësimin e të dhënave mbi migracionin. Gjithashtu, jepen sugjerime për bërjen e profilit të migracionit më të përditësueshëm, si dhe rekomandimet kryesore për politikëbërësit për përmirësimin e menaxhimit aktual të migracionit.

A. PARATHËNIE

A.1 Modelet e fundit të migracionit: Një përmbledhje e shkurtër

Shqipëria është një vend me një popullsi të regjistruar me mbi 4 milionë banorë. Krahasuar me numrin e përgjithshëm të popullsisë, Shqipëria ka aktualisht përqindjen më të lartë të emigracionit në Evropë, por jo vetëm. Megjithatë nuk ka statistika të sakta mbi emigracionin, përlllogaritet së rreth 25 % e popullsisë shqiptare banojnë jashtë vendit. Nga ana tjetër, imigracioni zë një përqindje të vogël (rreth 0.3% të popullsisë totale që banojnë në Shqipëri) dhe bazohet kryesisht në imigrimin për motive punësimi. Përveç imigrantëve për qëllime punësimi, gjatë viteve të fundit është rritur përqindja e atyre për qëllime të ribashkimit familjar apo për qëllime studim. Ndërkohë, vihet re një ulje e numrit të të huajve rezidentë për aktivitete humanitare.

Historia e migracioni shqiptar fillon që në kohërat e hershme të pushtimit të Perandorisë Otomane turke, vazhdon gjatë periudhës së krijimit të shteteve të Evropës Juglindore në fund të shekullit 19-të e fillim të atij të 20-të, për të vazhduar në përmasa të konsiderueshme në vitet 1991, 1997 e 1998. Një përshkrim të zgjeruar mbi këtë historik gjendet në Profilin e zgjeruar Kombëtar mbi Migracionin të vitit 2010⁵.

Liberalizimi i vizave për shtetasit shqiptarë me vendet e BE/Shengenit në fundin e vitit 2010, pati ndikim të drejtpërdrejtë në reduktimin e emigracionit të parregullt shqiptar drejt vendeve të BE-së. Ndërkohë, konfliktet e armatosura në vendet e Afrikës Veriore dhe atyre arabe, nga viti 2010 e në vazhdim, janë shoqëruar me valë të reja migratore nga këto vende drejt Shqipërisë si vend transit, me

⁵ www.asp.gov.al "Profili vjetor mbi migracionin për vitin 2010"

destinacion vendet e BE-së.

Përgjithësisht Shqipëria vazhdon të konsiderohet si një vend origjine i emigracionit, si vend që është tentuar të jetë vend transit i emigracionit të paligjshëm, por dhe si vend destinacioni i imigracionit.

Emigracioni i paligjshëm shqiptar më shumë është zhvilluar drejt vendeve fqinje si Greqi (98%) dhe Italia, por dhe vende të tjera të BE-së, si: Gjermania, Franca, Belgjika, Holanda, Britania e Madhe, Luksemburgu, Suedia etj. Emigracioni i paligjshëm është shfaqur nëpërmjet 2 formave të tij:

- Së pari, atë të daljes së ligjshme nga Shqipëria drejt vendeve të BE-së, falë mundësisë së lëvizjes pa viza dhe më pas keqpërdorimi i këtyre mundësive, ose duke tejkaluar afatet e qëndrimit, ose duke aplikuar për azil pa arsye; dhe

- Së dyti, daljes në mënyrë të paligjshme ndërmjet kufirit tokësor drejt vendeve fqinje dhe më pas qëndrimit po në mënyrë të paligjshme në vendet e BE/Shengen.

Si vend destinacioni i imigracionit, Shqipëria vitet e fundit, gjithashtu, ka njohur formën e imigracionit të paligjshëm dhe atë të ligjshëm.

Imigracioni transit në vitet 2011, 2012 dhe 2013 ka shënuar shifrat gjithnjë e në rritje. Në këto vite ky emigracion është shfaqur në dy forma të zhvillimit të tij, atë të hyrjes në mënyrë të paligjshme në Shqipëri dhe më pas tentimin për të transituar po në mënyrë ilegale nëpërmjet territorit të Republikës e Shqipërisë drejt vendeve të tjera të rajonit e me destinacion final vendet e BE-së (kryesisht shtetas nga Afganistani, Siria, Tunizia, Maroku, Algjeria, Palestina etj.), si dhe në raste më të rralla atë të hyrjes në mënyrë të ligjshme e më pas transitimin drejt vendeve të tjera (kryesisht shtetas turq dhe shtetas nga Kosova).

Imigracioni i paligjshëm në vitet 2011, 2012 dhe 2013 është zhvilluar kryesisht nëpërmjet hyrjes së ligjshme dhe më pas qëndrimit të paligjshme. Krahësaj, shënohet një tendencë në rritje e hyrjes në mënyrë të paligjshme dhe më pas qëndrimin në mënyrë të paligjshme.

Rritja e numrit të rasteve të zbuluara të imigracionit të paligjshëm i ardhur nga hyrja e ligjshme dhe qëndrimi me pas i paligjshëm, pasqyron në fakt më shumë efektivitetin e masave të marra për zbulimin e imigracionit të paligjshme se sa një rritje të ndjeshme të këtij imigracioni. Ndërsa, rritja e rasteve të zbuluara të imigracionit të paligjshëm i ardhur nga hyrja dhe më pas qëndrimi i paligjshëm ka ardhur sa si rezultat i rritjes së flukseve migratore të shtetasve të vendeve të Afrikës dhe atyre arabe, po aq dhe i rritjes së fuqisë zbuluese në territor të strukturave të kufirit dhe migracionit, por dhe atyre të tjera të Policisë së Shtetit.

Imigracioni i ligjshëm është zhvilluar kryesisht për motive punësimi, bashkimi familjar por dhe për motive të tjera si ato për studime apo të aktiviteteve humanitare dhe fetare. Në vitet 2011, 2012 dhe 2013 vihet re një rritje e numrit të imigrantëve të ligjshëm për motive studimi, si dhe një ulje e numrit të imigrantëve të përfshirë në aktivitete fetare dhe humanitare.

Të dhënat statistikore më të fundit tregojnë se numri i emigrantëve të ligjshëm pati rritje në vitet 2011, 2012 dhe 2013, po ashtu për shkak të investimeve të huaja në vend. Kërkesat për marrjen e shtetësisë shqiptare janë bërë kryesisht nga shtetas me etni shqiptare.

B. ANALIZA E STRUKTURËS SOCIAL-EKONOMIKE TË MIGRACIONIT

B.1 Ndryshimet demografike

Duke analizuar popullsinë shqiptare të regjistruar sipas Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, struktura demografike rezulton si në vijim.

- Ndarja popullsisë së regjistruar sipas qarqeve:

Nga këto statistika, për periudhën 2011-2014 vihet re një rritje e vogël e popullsisë në zonat urbane e industriale dhe një ulje e vogël e popullsisë në zonat më rurale. Ky ndryshim i vogël shpjegohet nga regjistrimi i lindjeve, vdekjeve dhe procesi i konsolidimit të të dhënave të RKGJC-së, si dhe me lëvizjen demografike të popullsisë në këto vite.

Siç rezulton dhe nga të dhënat e tabelës, gjatë periudhës 3-vjeçare (janar 2011 – janar 2014) vërehet një rritje në total e numrit të popullsisë së regjistruar me shtetësi shqiptare prej 1.48%.



QARKU	Janar 2011	Janar 2012	Janar 2013	Janar 2014	Rritja e popullsisë
Berat	231,323	232,181	231,229	230,450	-0.38%
Dibër	180,183	180,081	178,915	177,783	-1.34%
Durrës	410,375	414,620	418,748	422,149	2.83%
Elbasan	427,325	431,541	434,170	435,106	1.80%
Fier	486,785	490,230	491,289	493,274	1.32%
Gjirokastrë	156,356	155,188	154,091	152,312	-2.62%
Korçë	352,643	352,915	352,396	350,511	-0.61%
Kukës	109,387	109,352	108,914	108,552	-0.77%
Lezhë	212,507	214,210	215,137	215,626	1.45%
Shkodër	331,641	333,280	330,360	331,045	-0.18%
Tiranë	993,347	1,008,412	1,021,479	1,035,152	4.12%
Vlorë	373,669	375,841	377,012	377,366	0.98%
TOTAL	4,265,541	4,297,851	4,313,740	4,329,326	1.48%

- Popullsia e regjistruar në janar 2014, ndarë sipas gjinisë dhe grup-moshave:

	Përqindja sipas gjinisë		Përqindja sipas grup-moshave		
	Femra	Meshkuj	0-14	15-64	Mbi 64
Berat	48.66%	51.34%	17.42%	72.79%	9.79%
Dibër	48.61%	51.39%	20.77%	70.65%	8.58%
Durrës	49.08%	50.92%	19.19%	71.64%	9.17%
Elbasan	48.86%	51.14%	19.28%	72.07%	8.65%
Fier	48.32%	51.68%	17.66%	72.52%	9.82%
Gjirokastrë	49.12%	50.88%	14.58%	72.72%	12.69%
Korçë	49.46%	50.54%	16.23%	71.94%	11.83%
Kukës	49.20%	50.80%	20.65%	70.31%	9.05%
Lezhë	48.84%	51.16%	19.30%	71.81%	8.88%
Shkodër	49.08%	50.92%	17.59%	71.62%	10.79%
Tiranë	49.73%	50.27%	18.01%	71.86%	10.14%
Vlorë	49.14%	50.86%	16.18%	73.29%	10.53%

Ndërkohë, struktura demografike e popullsisë banuese në Shqipëri, sipas publikimeve të INSTAT-it, ku si referencë janë marrë të dhënat e Censurit të Popullsisë dhe Banesave të vitit 2011 dhe studimet në vazhdimësi, rezulton se struktura e popullsisë (banuese në Shqipëri) paraqitet si më poshtë:

- Volumi i popullsisë

	2010	2011	2012	2013
Popullsia në fillim të vitit	2918.7	2907.4	2902.2	2898.8
Meshkuj	1459.6	1455.7	1454.5	1457.3
Femra	1459.0	1451.7	1447.7	1441.5

Popullsia banuese në Shqipëri është më pak se 3 milionë banorë dhe rezulton me një rritje negative që prej vitit 2001. Pas Censurit të fundit të Popullsisë dhe Banesave, shifrat sa i përket përlogaritjeve të popullsisë janë bazuar në kombinimin e rezultateve të censuseve të Popullsisë dhe Banesave 2001 dhe 2011 dhe eventeve demografike (lindje dhe vdekje) që vijnë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. INSTAT-i, duke u bazuar në të dhënat e dy censuseve të fundit, me anë të një metode indirekte



arriti të estimonte numrin e emigrantëve shqiptarë gjatë dekadës midis dy censuseve të fundit, 2001-2011. Nga kjo llogaritje rezultoi se numri i emigrantëve shqiptarë është **481601**.

- Shpërndarja e popullsisë banuese sipas moshës më 1 janar (sipas gjinisë)⁶

MOSHA	2010	2011	2012	2013
0-14 vjeç	656952	626870	602069	576507
15-64 vjeç	194 063	1959845	1972880	985000
Mbi 60 vjeç	313659	320646	327241	337275
TOTALI	2918674	2907361	2902190	2898782

- Indeksi sintetik i fekonditetit (TFR)

	2010	2011	2012	2013
Fertiliteti Total	1.66	1.69	1.78	1.76

- Lindjet, vdekjet dhe shtesa natyrore, 2010-2013

	Lindje	Vdekje	Shtesa natyrore
2010	34,061	20,107	13,954
2011	34,285	20,012	14,273
2012	35,473	20,870	14,603
2013	35,750	20,442	15,308

- Shkalla e urbanizimit sipas vendbanimit më 1 janar (sipas gjinisë dhe moshës)⁷

VENDBANIMI	2010	2011	2012	2013
Qytetet (%)	52	53	54	56
Fshatrat (%)	48	47	46	44

- Dendësia e popullsisë

	2010	2011	2012	2013
Dendësia	102	101	101	101

Jetëgjatësia

Për vitet 2010-2013, INSTAT-i ka përllogaritur jetëgjatësinë mesatare në lindje në Shqipëri:

	2010	2011	2012	2013
Meshkuj	74.6	75.1	75.3	76.0
Femra	79.0	79.7	79.6	80.3

Sistemi shëndetësor në Shqipëri është kryesisht publik. Shteti është ofruesi kryesor i shërbimeve shëndetësore, i promovimit të shëndetit, parandalimit, i diagnostikimit dhe trajtimit të sëmundjeve.

- Dhënia e shërbimit shëndetësor

Kujdesi shëndetësor është një nga të drejtat themelore që ka njeriu. Legjislacioni shqiptar i shërbimit shëndetësor i njeh çdo shtetasi të huaj të punësuar në vend, çdo personi që ka përfituar statusin e azilantit në vendin tonë apo çdo shtetasi shqiptar pas kthimit (emigrantit) të njëjtin trajtim për kujdesje shëndetësore të siguruar edhe për shtetasin shqiptar.

⁶ Shiko tabelat shtesë në aneksin I.2.1 të këtij materiali

⁷ Të dhënat mbi popullsinë për vitet 2001-2013 janë llogaritur nga INSTAT



Dhënia e ndihmës mjekësore bazohet në ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 10138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik” dhe ligjin nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Kujdesi shëndetësor ofrohet nga shërbimi shëndetësor, i cili jep ndihmën e nevojshme mjekësore.

Në këtë kuadër personave të lartpërmendur u sigurohet kujdes shëndetësor nga shteti nëpërmjet edukimit shëndetësor, kontrollit dhe masave profilaktike të përgjithshme ose të veçanta, asistencës mjekësore (në shtëpi, ambulatorisht, spital).

- Sigurimet shëndetësore

Në bazë të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sigurimi i detyrueshëm shëndetësor bazohet në kontributet e të punësuarve, e të punëdhënësve të shtetit dhe në burime të tjera për persona të tjerë, siç parashikohet në këtë ligj, bazuar në parimin e solidaritetit. Skema e sigurimeve të detyrueshme shëndetësore synon në mbulimin e popullsisë në përfitimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, të financuara nga sektori publik dhe privat, në bazë të këtij ligji.

Shtetas të huaj rezidentë, sipas shtetësisë⁸:

VITET	2010	2011	2012	2013
EUROPA (nga të cilët):	4114	4813	5407	6163
Vendet e BE-së	1572	2063	2714	3293
Turqi	1648	1542	1636	1712
Vendet e rajonit ⁹	779	832	948	1032
Të tjera	115	376	109	126
AZIA	731	775	750	965
Nga të cilët: Kina	381	359	318	298
AMERIKA	623	818	967	945
Nga të cilët: SHBA	463	567	643	578
AFRIKA	187	193	184	245
TOTALI	5663	6615	7353	8330

- Përfitimi dhe lënia e shtetësisë

Sipas statistikave të Drejtorisë për Shtetësinë dhe refugjatët në Ministrinë e Brendshme rezulton së gjatë viteve 2011, 2012 dhe 2013 krahasuar me vitin paraardhës, janë regjistruar:

	2010	2011	2012	2013
Lënie shtetësie	370	254	322	595
Fitim shtetësie	95	228	205	221
Dhënie/njohje shtetësie				59
Rifitim shtetësie	42	156	124	64
Totali	507	638	651	939

- Tabela përmbledhëse e migracionit

	Imigrantë	Emigrantë	Diferenca në migrim	Shtetasit e huaj rezidentë në Shqipëri (1 janar)	
				Numri	%
2010	5663	Mungojnë të dhënat	-	5663	0.18
2011	6615	Mungojnë të dhënat	-	6615	0.22
2012	7353	Mungojnë të dhënat	-	7353	0.25
2013	8330	1 252 066¹⁰	1243736	8330	0.3

⁸ Burimi i të dhënave, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

⁹ Rajoni përfshin vendet e Ballkanit Perëndimor : Mali i Zi, Kosovë, Maqedoni, Kroaci, Serbi, Bosnjë-Hercegovinë

¹⁰ E dhënë e përafërt sipas të dhënave të publikuar nga UN në <http://esa.un.org/unmigration/TIMSO2013/migrantstocks2013.htm?msdo>



B.2 Ekonomia dhe klima ekonomike

- Indikatorët kryesorë makroekonomikë (GDP realë dhe GDP për frymë):

	GDP (në miliard ALL)	GDP indeks i vëllimit (viti paraardhës =100) në %	Për frymë GDP në vlerën aktuale në USD
2008	1.089,30	7,5	4.374
2009	1.151,00	3,4	4.110
2010	1.231,10	3,7	4.089
2011	1.300,62	2,5	4.437
2012	1.335,49	1,6	4.257

- Shkalla e inflacionit

Viti	Inflacioni vjetor në %
2010	3,6
2011	3,4
2012	2,0
2013	2,0

- Debiti publik

Viti	Debiti vjetor në % të PBB
2010	58.52
2011	60.26
2012	62.46
2013	65.18

-Investimet e kapitalit¹¹

	Shpenzimet kapitale (çmimi aktual), mln ALL	Shpenzimet kapitale Norma e rritjes nominale (%)	Shpenzimet kapitale (në % të GDP)
2010	67,492	-29.6	5.5
2011	95,881	42,1	7,4
2012	61,656	-35,7	4,6
2013	65,477	6,2	4,8

- Investimet direkt të huaja

Investimet e ndërmarrjeve FDI (milionë EUR)

2010	793.3
2011	630.4
2012	665.8
2013	953.2

¹¹ Shiko tabelat shtese në aneksin I.2.2 të këtij materiali
Faqe | 10702



- Sektorët kryesorë të punësimit¹², fuqia punëtore

	Viti 2012		Viti 2013			
	TM-III	TM-IV	TM-I	TM-II	TM-III	TM-IV
Te punësuar gjithsej nga të cilët:	960,004	962,434	963,316	904,496	910,842	926,561
Në sektorin publik	164,400	164,000	164,000	163,800	163,800	164,000
Në sektorin privat jo-bujqësor	272,667	278,063	280,968	282,034	288,380	311,668
Në sektorin privat bujqësor	522,937	520,371	518,348	458,662	458,662	450,893

- Tregu – Bilanci i tregut: importet dhe eksportet¹³

	Bashkimi Evropian (EU-27)	Të tjera jo EU	Totali	Afrika	Amerika	Azia	Australi Oqeani	Të tjera
IMPORTE								
2009	272302	77804	350106	3161	14573	62054	256	957
2010	292625	84547	377172	2715	14731	63081	226	504
2011	143643	53254	196897	983	2312	5834	6	77
2012	161154	51876	213030	1668	1238	7675	12	556
2013	189037	57354	246391	1841	1374	13692	0	12
EKSPORTE								
2009	81627	14365	95992	772	982	5392	3	103
2010	112963	32896	145859	1746	2755	10550	0	52
2011	355071	188932,92	544003,9	3078	20015	62725	594	655
2012	334001	194490	528491	3272	23791	58638	304	1513
2013	332804	184508	517312	14340	24060	51368	261	898
BILANCI								
2009	-190675	-63439	-254114	-2389	-13591	-56662	-253	-854
2010	-179662	-51651	-231313	-969	-11976	-52531	-226	-452
2011	-211428	-135679	-347107	-2095	-17703	-56890	-588	-578
2012	-172847	-142614	-315461	-1604	-22553	-50963	-292	-957
2013	-143767	-127154	-270921	-12499	-22686	-37676	-261	-886

¹² Burimi: INSTAT (Instituti i Statistikave) Anketa Tremujore e Forcave të Punës. Për vitin 2011, INSTAT-i nuk disponon të dhëna tremujore meqenëse është kryer anketa vjetore e forcave të punës ndërsa të dhënat administrative tremujore nuk janë paraqitur sepse nuk kanë krahasueshmëri me të dhënat e anketës. Për më shumë informacion mund të konsultohet website i INSTAT: <http://www.instat.gov.al/al/themes/pagat-dhe-kosto-e-punes.aspx>.

¹³ Burimi: INSTAT (Instituti i Statistikave)

- Indeksi i çmimit të konsumatorit për grupet kryesore (viti i mëparshëm = 100.0)¹⁴

	Ushqim, pije joalkoolike	Pije alkoolike, duhan	Veshje dhe këpucë	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	Mobilim, pajisje shtëpie, mirëmbajtje	Mallra dhe shërbime të ndryshme	Totali
2008	100.9	100.7	96.5	103.3	100.1	100.4	101.1
2009	105.9	104.2	94.6	105.1	100.5	101.2	103.4
2010	111.4	109.9	93.2	108.9	101.0	102.9	107.1
2011	116.2	122.8	91.4	111.9	101.9	103.2	110.8
2012	119.0	125.6	89.4	112.9	103.3	109.3	113.0
2013	124.0	130.0	86.1	113.2	103.9	108.9	115.2

- Rritja reale e pagës (%), 2010-2013

	2010	2011	2012	2013
Ndryshimi vjetor i pagës mujore në sektorin shtetëror	6.7	6.9	7.3	4.1
Ndryshimi mesatar vjetor i çmimeve të konsumit	3.6	3.4	1.9	2.1
Ndryshimi i pagës reale	3	3.4	5.2	2

B.3 Analiza e tregut të punës

B.3.1 Zhvillimet më të fundit të tregut të punës në vend

Legjislacioni dhe politikat e punësimit

Përveç sa legjislacioni ekzistues mbi nxitjen e punësimit, i përmendur në Profili e zgjeruar të Migracionit të vitit 2010¹⁵, një ndikim në politikën e punësimit parashikohet të kenë Strategjia mbi Rintëgrimin e të kthyerve dhe Plani i saj i Veprimt (2010-2015), ligji nr. 108/2013 "Për të huajt", si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Sipas përcaktimeve në Strategjinë e Riintegrit të të Kthyerve dhe planin e saj të veprimt 2010-2015, ndër të tjera ofrohet me shumë asistencë në drejtim të:

- mbështetjes së riintegrit ekonomik të shtetasve shqiptarë të kthyer përmes programeve të nxitjes së punësimit;
- mbështetjes së riintegrit ekonomik të shtetasve shqiptarë të kthyer përmes përfshirjes në kurset publike të formimit profesional;

- mbështetjes së riintegrit të shtetasve shqiptarë të kthyer në Shqipëri në sistemin shëndetësor, sigurimeve shëndetësore dhe mbrojtjes sociale;
- mbështetjes së riintegrit të shtetasve shqiptarë të kthyer nga zonat rurale, përmes programeve për nxitjen e investimeve në bujqësi;
- mbështetjes së riintegrit të shtetasve shqiptarë të kthyer përmes bashkëpunimit me shoqërinë civile etj.

Ligji nr. 108/2013 "Për të huajt" përmirëson në mënyrë të ndjeshme politikat e punësimit ndaj të huajve, politika të cilat pritet të kenë një ndikim dhe në tregun e brendshëm të punës. Ndryshe sa në ligjin paraardhës, ky ligj heq kushtin për vlerësimin e përfitimit ekonomik të veprimtarisë së të vetëpunësuarit si kusht për pajisjen e të huajt me leje pune, në kundërshtim me kriteret e OBT-së, por ndërkohë përcakton detyrimin e ministrisë përgjegjëse për politikat e punësimit me Ministrinë e Ekonomisë që çdo vit të hartojnë dhe të miratojnë më pas kuotat vjetore të punës. Të drejtat në fushën e punësimit për shtetasit e BE-së, atyre të SHBA-së dhe disa vendeve të tjera, të barabarta me shtetasit shqiptarë, janë një risi e re e mundësuar nga ligji nr. 108/2013, por që nuk pritet të kenë një ndikim në tregun e punës, ndërkohë që mund të mbështesë më mirë me fuqi punëtore të kualifikuar këtë treg. Lehtësirat e parashikuara për investitorët të cilët investojnë mbi 1 milion euro dhe punësojnë mbi 10 shtetas shqiptarë së paku për një vit, gjithashtu, pritet të këtë një impakt pozitiv në tregun e punës.

¹⁴ Burimi: INSTAT (Instituti i Statistikave)

¹⁵ Web: www.asp.gov.al



B.3.2 Punësimi të huajve

Treguesit sasiorë mbi lejet e punës

Duke u mbështetur në lejet e punës dhe vërtetimet për punësim të lëshuara sipas ligjit nr. 108/2013, datë 28.3.2013 "Për të huajt", si dhe VKM-ve me nr. 348 – 360, datë 6.3.2009, situata e punësimit të shtetasve të huaj, sipas sektorëve të aktiviteteve që ata ushtrojnë në territorin e Shqipërisë krahasuar me vitet paraardhës paraqitet si më poshtë 16:

Për vitin 2011: Janë pajisur me leje pune 2300 shtetas të huaj dhe janë përjashtuar nga detyrimi për pajisjen me leje pune 74 shtetas të huaj.

Për vitin 2012: Janë pajisur me leje pune 2499 shtetas të huaj dhe janë përjashtuar nga detyrimi për pajisjen me leje pune 180 shtetas të huaj. Janë pajisur me leje për herë të parë 1830 shtetas të huaj ose 73% e totalit.

Për vitin 2013: Janë pajisur me leje pune 2189 shtetas të huaj dhe janë përjashtuar nga detyrimi për pajisjen me leje pune 199 shtetas të huaj.

Shpërndarja e lejeve të punës së lëshuara për të huajt, sipas zyrave të punës që i kanë lëshuar ato është si në tabelë:

	2011	2012	2013
DRSHKP –Tiranë	50 %	48 %	50 %
DPSHKP	16 %	20%	13.7 %
DRSHKP- Lezhë			7.7 %
DRSHKP- Fier	8%	9%	7.7 %
DRSHKP-Shkodër	7 %		
DRSHKP-Durrës		5%	

Tipi i lejeve të punës

Në vitin 2011, vendin e parë e zënë punëmarrësit (1773 A/P +154 A/TN+ 4 A/AF + 7 A/NK) me një rritje prej 30 % krahasuar me një vit më parë. Më pas vijnë të vetëpunësuarit (161 B/ VP) edhe kjo kategori me 20 % rritje duke iu referuar vitit 2010.

Edhe në vitin 2012, vendin e parë e zënë kërkesat për leje pune për kategorinë e punëmarrësve, përkatësisht (1802 A/P + 142A/TN + 11A/NK+10 A/AF), shifër kjo me një rritje të lehtë prej 2 % krahasuar me një vit më parë. Në vend të dytë kemi kategorinë e vetëpunësuarve (258 B/VP) duke iu referuar vitit 2011 në masën 60 % dhe në vendin e tretë kategoria e investitorëve me leje pune tipi B/I. Kategori e cila nuk ka pësuar ndonjë ndryshim shumë të madhe.

Për vitin 2013 vendin e parë e zënë kërkesat për leje pune për kategorinë e punëmarrësve, përkatësisht 1888 leje pune (1664 A/P + 41 A/TN + 1 A/AF + 5 A/NK + 1 A/PS , 168 C/RV + 7 C/SP + 1 C/PSH), shifër kjo me një rritje prej 5 % krahasuar me një vit më parë. Në vend të dytë kemi kategorinë e të vetëpunësuarve me 234 leje pune (234 B/VP), referuar vitit 2013 me një ulje në masën 10 %. Në vendin e tretë, kategoria e investitorëve me leje pune tipi B/I, e cila ka pësuar një ulje të lehtë.

Në tabelën e mëposhtme jepet shpërndarja e lejeve të punës sipas tipit të lejeve të punës:

	A/P	A/TN	A/AF	A/NK	B/VP	B/I	C/S	C/PSH	C/RV	D	A/S	A/PS	A/AF	A/AF	A/SHV
2011	1773	154	4	7	161	17	11	3	139	31					
2012	1802	142	10	11	258	23	9	8	193	35	1		1	1	6
2013	1664	41	1	5	233	15	7	1	168	54		1			

¹⁶ Tabela e përgjithshme : Leje pune të ndara sipas organit lëshuese, referohu aneksit I.2.3



Sektorët e aktivitetit

Në tabelë jepet kategorizimi i lejeve të punës për sektorët e aktivitetit ku shtetasit e huaj janë më të punësuar për vitin 2013 krahasuar me vitet 2011 dhe 2012.

	2011		2012		2013	
	LP	%	LP	%	LP	%
Tregti dhe riparim automjesh	358	16	360	15.4	265	12
Industri nxjerrëse	265	12	301	12	216	9.8
Aktivitete shërbimesh të tjera	244	11	166	7	278	13
Ndërtim	281	10	476	19	548	25
Industri përpunuese	184	8	201	8 %	224	10

Kategorizimi sipas shteteve

Sipas ecuresë vjetore të dhënies së lejeve të punës nga Drejtoria e Përgjithshme, drejtoritë Rajonale dhe zyrat vendore rezulton se numrin më të madh sipas shteteve e zënë shtetet e renditura në tabelë.

	2011		2012		2013	
	LP	%	LP	%	LP	%
Turqi	593	26	474	19	865	39.5
Kinë	273	12	188	7.5	112	5
Itali	243	10	372	15	170	7.7
Greqi	172	8	388	16	139	6, 3
Kanada			195	8	156	7, 1
Kosovë			105	4	165	7, 5

Kategorizimi sipas gjinisë

Numri i përfituesve të lejeve të punës për të huaj sipas gjinisë rezulton si vijon:

Siç edhe vihet re nga ndarja në tabelë, shtetas të huaj të pajisur me leje pune janë më së shumti meshkuj në raportin 6 : 1 me numrin e shtetaseve të huaj.

	2011	2012	2013
Meshkuj	1965	2153	1936
Femra	335	346	253

Përfshirja nga detyrimi i lejes së punës

Në zbatim të ligjit nr. 9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt" (i shfuqizuar) dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe nga 20 prilli 2013 të ligjit "Për të huajt", nr. 108/2013, datë 28.3.2013, nga Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Migratore janë shqyrtuar kërkesat e shtetasve të huaj për t'u përjashtuar nga detyrimi për t'u pajisur me leje pune. Për periudhën janar-dhjetor 2013 janë miratuar gjithsej 199 përjashtime nga detyrimi për t'u pajisur me leje pune¹⁷ për shtetas të huaj, duke u pajisur me leje të tipit TP si më poshtë:

Përfituese të lejes të tipit TP sipas gjinisë

Nga 199 persona gjithsej, 115 janë me banim në Tiranë.

Nga 199 persona gjithsej, 66 janë shtetas të BE-së të pajisur me dokumentin e përjashtimit nga detyrimi për leje pune.

	2011	2012	2013
Femra	3	41	78
Meshkuj	71	139	121
Totali	74	180	199

¹⁷ Tabela e përgjithshme sipas vendbanimit dhe shtetësisë, aneksi I.2.3



B.3.3 Treguesit cilësorë për lejet e punës për të huajt dhe përjashtimet

Nga vlerësimi analitik i të dhënave statistikore të mësipërme, rezultojnë këto karakteristika dhe tendenca të fluksit të hyrjeve të shtetasve të huaj për qëllime punësimi:

Nëse do të analizojmë numrin e shtetasve të huaj që janë në marrëdhënie pune pranë subjekteve të huaja, filialeve të tyre në Shqipëri apo ata që janë vetë investues, shikojmë një tendencë pozitive punësimi që detyrimisht çon në rritjen e numrit të këtyre shtetasve. Nëse në vitin 2011 kemi 2300 leje pune të dhëna nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe në vitin 2012 kemi 2499 leje pune, kjo e dhënë në vitin 2013 është 2958 ose 16 % më shumë se një vit më parë.

Për vitin 2012, sektorët më preferencialë ishin sektori i ndërtimit, i cili zinte 20 % të fushave të tjera të aktivitetit, e pasuar nga sektori i tregtisë, i cili ishte në masën 14 %. Sektori i ndërtimit edhe në vitin 2013 është në vendin e parë me një karakteristikë ndryshe; - nuk bëhet fjalë për ndërtim banesash, por ky sektor është zgjeruar në ndërtim rrugësh apo hidrocentralesh, siç është ai i Banjës, Rrëshenit etj.

Drejtoria e Punësimit që ka pasur fluksin më të madh të shtetasve të huaj për t'u pajisur me leje pune për vitet 2011, 2012 dhe 2013 është ajo e Tiranës me gati 50% të lejeve të punës.

Për vitin 2013, vendin e parë e zënë kërkesat për leje pune për kategorinë e punëmarrësve, përkatësisht 1888 leje pune (1664 A/P + 41 A/TN + 1 A/AF + 5 A/NK + 1 A/PS, 168 C/RV + 7 C/SP + 1 C/PSH), shifër kjo me një rritje të lehtë prej 5 % krahasuar me një vit më parë. Në vend të dytë kemi kategorinë e të vetëpunësuarve me 234 leje pune (234 B/VP), referuar vitit 2013 me një ulje në masën 10 %. Në vendin e tretë, kategoria e investitorëve me leje pune tipi B/I, e cila ka pësuar një ulje të lehtë krahasuar me dy vitet e mëparshme.

Po të krahasojmë fluksin e të huajve sipas shtetësisë, vendin e parë e zënë shtetasit nga vendet joanëtare të BE-së, si shtetasit turq, të cilët në rast se në vitet 2011 dhe 2012 përbënin përkatësisht 26% dhe 19% të numrit total, në vitin 2013 përbëjnë 39.5% të tij, pasuar nga ata kinezë, të cilët në më të shumtën e rasteve janë të vetëpunësuar dhe më pas shtetasit e BE-së italianë dhe grekë.

Gjatë viteve 2011, 2012 dhe 2013, të pajisur me leje pune janë më së shumti meshkuj, kurse në vitin 2013 vihet re një rënie e lehtë e femrave të pajisura me leje pune, krahasuar me vitet e mëparshme.

Për shkak se Shqipëria po bëhet nga viti në vit edhe më atraktive për të huajt, si dhe të klimës pozitive ndaj biznesit në përgjithësi dhe sidomos atij të huaj, për vitet në vazhdim pritet të jetë në rritje numri i shtetasve të huaj që paraqiten për t'u pajisur me leje pune, kryesisht për kategorinë e punëdhënësve, të punëmarrësve për profesionet e larta, si dhe të vetëpunësuarve.

Rrethet ku është përqendruar pjesa më e madhe e të huajve që kryejnë aktivitet, janë: Tirana, Shkodra, Elbasani.

Për sa i përket informacionit mbi përjashtimet nga detyrimi për pajisje me leje pune për periudhën 2011-2013, vihet re një tendencë në rritje e këtyre kategorive të pajisura me këtë dokument, rritja është shumë e ndjeshme nga viti 2011 me 74 persona, në 180 në vitin 2012, kurse për vitin 2013 kemi 199 persona.

Për sa i përket gjinisë edhe pse shumica e persona kanë qenë meshkuj, në vitin 2013 vihet re një rritje me gati 50% i numrit të femrave krahasuar me një vit më parë.

Qyteti ku janë përqendruar më shumë këta shtetas është Tirana me 115 persona në vitin 2013.

Sipas shtetësisë dominojnë ata italianë, të ndjekur nga ata kinezë dhe turq.

B.3.4 Shkalla e papunësisë


Shkalla e papunësisë është një nga treguesit më të njohur të tregut të punës i cili tregon përqindjen e personave të papunë ndaj popullsisë ekonomiksht aktive.

Nga viti 2000 deri në 2006 shkalla e papunësisë i referohej vetëm papunësisë së regjistruar. Nga nevoja për të pasur vlerësime sa më të sakta për këtë tregues të rëndësishëm si social, ashtu dhe makroekonomik për një vend, si dhe për një përfaqësim sa më të mirë e të plotë të popullsisë në moshë pune në Shqipëri, në vitin 2007 u krye për herë të parë Anketa e Forcave të Punës (AFP), duke siguruar treguesit e papunësisë edhe nëpërmjet anketave pranë familjes. Kjo anketë vijoi të kryhej me periodicitet vjetor deri në vitin 2011 dhe që prej vitit 2012 është një anketë e vazhdueshme dhe bazuar në të publikohen të dhëna tremujore. Për vitin 2013 shkalla vjetore e papunësisë matur nga AFP ishte 15.6%.

Duke analizuar shkallën e papunësisë në vite për periudhën 2011-2013, të dhënat mbi tregun e punës në Shqipëri flasin për një pabarazi ndërmjet femrave dhe meshkujve. Në bazë të Anketës së Forcave të Punës, gjatë kësaj periudhe shkalla e papunësisë ka rezultuar më e lartë ndër meshkujt, duke evidentuar kështu një shkallë më të lartë të përpjekjeve për të gjetur punë të meshkujve krahasimisht me femrat. Në vitin 2013 shkalla e papunësisë e meshkujve rezulton 4.3 pikë përqindje më e lartë se e femrave (respektivisht 17.5% për meshkujt dhe 13.2% për femrat).

Shkalla e papunësisë në Shqipëri paraqitet në nivele të larta ndër të rinjtë. Për të rinjtë në moshë 15-29 vjeç, ajo rezulton në rritje për periudhën 2011-2013, me vlera respektivisht 21.9, 25.0, 26.7 %.

Shkalla e papunësisë për popullsinë në moshë 15 vjeç e lart dhe të rinjtë 15-29 vjeç, 2007-2013¹⁸ paraqitet në grafikun në vijim:



Një tregues tjetër i rëndësishëm i tregut të punës është përqindja që zënë të papunët afatgjatë, pra të papunët që kanë 12 muaj e më shumë pa punë, ndaj totalit të të papunëve. Papunësia afatgjatë karakterizon tregun shqiptar të punës në vite duke qëndruar në nivele të larta. Në vitin 2013, të papunët afatgjatë përbënin 72,8% të të papunëve gjithsej.

Një tjetër tipar dallues i tregut shqiptar të punës është pjesa relativisht e lartë e të papunëve të dekurajuar (të moshës 15-64 vjeç), të cilët në vitin 2013 përbënin 23% të të gjithë individëve ekonomikisht joaktivë (20,8% meshkuj dhe 24,2% femra). Të papunët e dekurajuar janë ata persona të cilët nuk po kërkojnë punë pasi besojnë që nuk ka punë të disponueshme për ta. Ata klasifikohen në grupin e popullsisë ekonomikisht joaktive.

Ndër të papunët e regjistruar, numri i të papunëve që përfitojnë nga skema e pagesës së papunësisë ka ardhur duke rënë në vite dhe shprehur në përqindje ky numër në vitin 2013 përbën 5.4 % të totalit të të papunëve të regjistruar.

B.3.5 Niveli i të ardhurave¹⁹

Gjatë gjithë periudhës 1995-2009, vërehet një prirje në rritje e pagës mesatare mujore për një punonjës në sektorin shtetëror. Kjo nuk mund të thuhet për sa i përket prirjes në pagën reale, e cila është ndikuar nga luhatjet e inflacionit.

Gjatë periudhës 1995-1996, si rrjedhojë e qëndrueshmërisë së çmimeve të mallrave të ndryshme të konsumit dhe rritjes së pagave në sektorin shtetëror dy herë në vit, rritja e pagave ishte më e madhe se rritja e çmimeve. Kriza ekonomike që kaloi vendi ynë gjatë vitit 1997, solli si rrjedhojë uljen e ndjeshme të pagës reale, duke shënuar një rënie rreth 17 % në krahasim me atë të një viti më parë.

Në vitin 1999, çmimet e konsumit pothuaj nuk ndryshuan fare dhe paga reale në fund të këtij viti shënoi rritje, rreth 10 %. Një situatë e ngjashme vihet re edhe për vitin 2000 ku paga reale pësoi një rritje prej 17.7%.

Viti 2001 shënon një rritje të pagës mesatare mujore me 15.1%, ndërkohë që edhe çmimet e konsumit pësojnë rritje me rreth 3.1%, duke çuar në një rritje të pagës reale prej 11.6%. Në vitin 2003,

¹⁸ Burimi: Anketa e Forcave të Punës, 2007-2013

¹⁹ Të dhënat nga publikimet e INSTAT

rritja e pagës mesatare mujore është 8.5% ndërsa çmimet e konsumit rriten me 2.4%, duke sjellë rritje në pagën reale me 6%.

Në vitin 2005, rritja e pagës mesatare mujore është 9.9%, ndërsa çmimet e konsumit rriten me 2.4% duke sjellë rritje në pagën reale me 7.3%.

Në vitin 2007, rritja e pagës mesatare mujore është 17.1%, ndërsa çmimet e konsumit rriten me 2.9% duke sjellë rritje në pagën reale me 13.8%.

Në vitin 2008, rritja më e ulët e pagës reale prej 6 % ishte rrjedhojë e një rritjeje më të ulët pagës mesatare, prej 8.3% dhe ndryshimit të çmimeve të konsumit me 2.2%.

Në vitin 2009, rritja e pagës mesatare mujore prej 11.9% dhe rritja e çmimeve të konsumit me 3.5% ndikuan në rritjen e pagës reale në 8.1%

Në vitin 2010, rritja e pagës mesatare mujore ishte 6.7%, ndërsa çmimet e konsumit u rritën me 3.6%, duke rezultuar në një rritje të pagës reale prej vetëm 3%.

Në vitin 2011, rritja e pagës mesatare mujore prej 6.9% dhe rritja e çmimeve të konsumit prej 3.4% sollën një rritje të pagës reale prej 3.4%.

Gjatë vitit 2012, paga mesatare bruto për një të punësuar në sektorin shtetëror ishte 50,092 lekë. Krahësuar me vitin 2011, në terma nominalë ka një rritje të pagës mesatare mujore prej 7.3 %. Rritja reale e pagës mesatare mujore për një të punësuar në sektorin shtetëror nga viti 2011 në vitin 2012 ishte 5.2 %.

Sipas të dhënave administrative, paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë në sektorin shtetëror gjatë vitit 2013 ishte 52.150 lekë. Nisur nga klasat e pagave 34,3% e të punësuarve në sektorin shtetëror paguhet me një pagë mbi 60 mijë lekë në muaj.

Gjatë vitit 2013, ndryshimi në terma vjetorë i pagës mesatare mujore bruto për një të punësuar në sektorin shtetëror ishte 4,1%. Në terma realë rritja e pagës mesatare mujore bruto për një të punësuar në sektorin shtetëror ishte 2%.

Rritja reale e pagës (%), 2010-2013

	2010	2011	2012	2013
Ndryshimi vjetor i pagës mujore në sektorin shtetëror	6.7	6.9	7.3	4.1
Ndryshimi mesatar vjetor i çmimeve të konsumit	3.6	3.4	1.9	2.1
Ndryshimi i pagës reale	3	3.4	5.2	2

B.4 Kapitali njerëzor

- Niveli i edukimit²⁰

Shkalla e regjistrimit në edukimin primar dhe sekondar

Viti shkollor	Cikli i ulët		Cikël i lartë		Gjithsej	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
2005-06	222.402	107.009	244.408	118.246	466.810	225.255
2006-07	210.125	101.018	237.177	114.671	447.302	215.689
2007-08	199.454	95.453	228.981	110.855	428.435	206.308
2008-09	236.102	112.399	221.784	107.807	457.886	220.206
2009-10	224.781	106.917	215.214	104.225	439.995	211.142
2010-11	215.660	102.276	205.024	98.770	420.684	201.046
2011-12	206.617	97.583	197.087	94.563	403.704	192.146
2012-13	198.897	93.774	191.940	91.613	390.837	185.387
2013-14	195.720	92.609	181.354	85.995	377.074	178.604

²⁰ Tabela e zgjeruar, referohu aneksit I.2.4



Shkalla e regjistrimit me edukim tretësor
PUBLIK:

Universitete & fakultete	Gjithsej		Sistemi ditës	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Studentë gjithsej, nga këta ndjekin programin:	124413	72064	94202	55220
Bachelor	95607	53569	70704	39710
Master ose tjetër pas Bachelor	26178	17039	23498	15510
Doktoraturë	2628	1456		

PRIVAT:

Universitete & fakultete	Gjithsej		Sistemi ditës	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Studentë gjithsej, nga këta ndjekin Programin:	34550	16448	34147	16260
Bachelor	24022	10867	23813	10777
Master ose tjetër pas Bachelor	10528	5581	10334	5483

C. ANALIZA E SITUATËS MIGRATORE NË VEND

C.1 Imigracioni

Në përpunimin e të dhënave mbi imigracionin, janë përdorur 3 burime të dhënash: të dhëna nga Drejtoria e Migracionit dhe Ripranimeve në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin të Policisë Shtetit, nga Zyra Qendrore e Statistikave dhe të dhëna nga Drejtoria e Shtetësive Refugjatëve. Për një përkufizim më të qartë, duhet theksuar që për sa u përket imigrantëve rezidentë në Shqipëri, bëhet fjalë për imigrantët që qëndrojnë të paktën mbi 3 muaj në Shqipëri dhe janë të pajisur me leje qëndrimi, pra kanë qëndrim të rregullt në territor.

C.1.1 Imigracioni i rregullt

Numri i përgjithshëm i shtetasve të huaj që qëndrojnë në Shqipëri ka mbetur përafërsisht në 0.2%-0.3 % të popullsisë vendase gjatë kësaj dekade në Shqipëri. Të dhënat e imigracionit paraqesin një strukturë të qëndrueshme të imigrantëve që vijnë nga vendet e rajonit.

- Në vitin 2011, shumicën (rreth 73%) të imigrantëve e përbënin ata me origjinë evropiane, ndërsa 12% vinin nga Azia dhe 12 % nga Amerika.

- Në vitin 2012, rreth 74% të imigrantëve e përbënin ata me origjinë evropiane, 10% vinin nga Azia, 13 % nga Amerika dhe 2% nga Afrika.

- Në vitin 2013, vetëm 74% të imigrantëve e përbënin ata me origjinë evropiane, 12% me origjinë aziatike dhe 11 % me origjinë amerikane dhe 3% afrikane.

- Imigracioni nga vendet e tjera të botës ishte i papërfillshëm (1-2 %).


Prurjet migratore të shtetasve të vendeve të rajonit në kufi me Shqipërinë (Kosovë – Maqedoni – Mal i Zi – Serbi), kryesisht janë dominuar nga ata me kombësi shqiptare. Ndërmjet imigrantëve evropianë në tërësi për vitin 2013, 28 % (1712) ishin të shtetësisë turke, 25% (1553) ishin italianë, 17% (703) ishin nga vendet kufitare (kryesisht Kosovë - Maqedoni) dhe afërsisht 30% erdhën nga vende të tjera të Evropës. Pothuaj një e treta e imigrantëve aziatikë erdhën nga Kina (30%, gjithsej 298 persona). Imigrantët nga SHBA-ja përbënin 61 % (gjithsej 578 persona) të emigrantëve të kontinentit amerikan, ndërsa ata kanadezë vetëm 26% (252 persona). Imigrantët nga shtete afrikane zinin vetëm 3 % (245 persona) të numrit total të imigrantëve (8330) për vitin 2013.

Viza të lëshuara për shtetasit që përshihen në këtë regjim

	2010	2011	2012	2013
Aplikime	2640	2932	3166	3477
Viza në kufi			171	178
Refuzuar	404	281	345	353



Aplikime per viza




Viti 2013

	Aplikime	Refuzuar
Turqi	635	99
Kinë	456	45
Rusi	367	
Egjypt	198	32
Indi	193	41
Siri	192	59
Moldavi	94	
Libi	82	4
Gjeorgji	69	7
Kuvajt	52	6
Iran	52	4
Filipinë	41	12

Prurjet migratore në vite:

Shteti	2010	2011	2012	2013
Turqi	1649	1542	1636	1712
Itali	827	1065	1277	1553
Rajoni (vende fqinj)	601	920	948	1032
BE	1768	2241	2714	3293






Shtetas të huaj në Shqipëri²¹ (imigrantë) sipas grup-moshave dhe gjinisë

	0-14	15-19	20-24	25-29	30-39	40-49	50-59	60-X	TOTAL
Meshkuj									
2007	-	47	300	478	930	740	369	183	3047
2008	-	80	453	716	1506	1246	508	262	4771
2009	2	74	485	823	1735	1446	582	270	5417
2010	71	99	338	510	1147	905	468	296	3834
2011	196	93	331	517	1232	1003	592	365	4329
2012	306	172	432	509	1205	1066	658	402	4750
2013	317	212	507	527	1315	1170	803	480	5331
Femra									
2007	-	25	104	155	266	179	135	175	1039
2008	-	11	100	163	245	202	148	172	1041
2009	1	18	151	233	366	244	164	201	1376
2010	75	48	207	317	463	308	195	216	1829
2011	195	70	265	384	559	333	228	252	2286
2012	308	124	331	386	603	359	225	266	2602
2013	296	187	400	409	689	437	293	288	2999
Total									
2007	-	72	404	633	1196	919	504	358	4086
2008	-	91	553	879	1751	1448	656	434	5812
2009	3	92	634	1056	2101	1690	746	471	6793
2010	146	147	545	827	1610	1213	663	512	5663
2011	391	163	596	901	1791	1336	820	617	6615
2012	614	296	763	895	1809	1425	883	668	7353
2013	613	399	907	936	2004	1607	1096	768	8330

Të huajt imigrantë sipas vendit të origjinës²²

SHTETI	2010	2011	2012	2013
Evropa	4114	4813	5407	6163
Azia	733	775	750	965
Amerika	621	818	967	945
Afrika	181	193	211	245
Oqeania	8	16	18	12
TOTALI	5663	6615	7353	8330



²¹ Këto të dhëna janë marrë nga baza e të dhënave në Sektorin e Migracionit në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin

²² Tabela sipas shteteve, referohu aneksit I.2.6



Azilkërkues sipas shtetësisë


SHTETËSIA	2011	SHTETËSIA	2012	SHTETËSIA	2013
Bangladesh	1	Afganistan	2	Bosnjë Hercegovinë	1
Irak	2	Karaibe	1	Iran	137
Jordani	2	Kongo	5	Kroaci	1
Kosovë	7	Serbi	1	Mali i Zi	1
Pakistan	1	Turqi	1	Siri	18
Somali	3				
TOTALI	16		10		158

Përfitur statusin refugjat²³

SHTETI	2011	2012	2013
Kosovë	3	2	2
Afganistan	1		1
Siri		1	1
Turqi		1	
Kongo			3
Peru			1
TOTALI	4	4	9

Të huaj rezidentë sipas motivit të qëndrimit

MOTIVI	2010	2011	2012	2013
Aktivitet fitimprurës (punësim, vetëpunësim)	1962	1790	1916	2469
Studim	163	263	430	823
Bashkim familjeje	763	1127	1338	1390
Azilkërkues, refugjatë	40	12	5	214
Aktivitete fetare-humanitare	601	783	896	808
Të tjera	352	298	285	233
TOTALI	3881	4273	4870	5937



²³ Këto të dhëna janë marrë nga Drejtoria e Shtetësisë dhe Refugjatet në Ministrinë e Brendshme



C.1.2 Imigracioni i parregullt

Gjatë vitit 2010 ka pasur në numër më të madh, përkatësisht me 20.6% të refuzimit të hyrjeve në Republikën e Shqipërisë në raportime vitet pasuese 2011, 2012 dhe 2013. Kryesisht shtetasit e refuzuar janë me shtetësi turke 27%, serbe, 8.9%, kosovare 8.1%, meksikane 3%.

Të huajt që iu është refuzuar hyrja në kufi gjatë periudhës 2010-2013

	2010	2011	2012	2013
Të huajt të refuzuar	503	394	278	305

Të huajt të refuzuar sipas shtetësive kryesore në vitet 2009-2013

SHTETËSIA	2010	SHTETËSIA	2011	SHTETËSIA	2012	SHTETËSIA	2013
Turqi	136	Turqi	106	Kosove	85	Turqi	43
Serbi	45	Iran	44	Rusi	38	Kosove	42
Kosovë	41	Kosove	32	Meksike	21	Rusi	35
Maqedoni	25	Rusi	23	Mal i Zi	20	Greqi	24
Meksikë	17	Meksike	17	Maqedoni	10	Armeni	24
TOTALI	503	TOTALI	394	TOTALI	278	TOTALI	305

Përgjithësisht, arsyet e refuzimit kanë qenë për:

- mungesë të mjeteve financiare;
- nuk disponojnë vizë të vlefshme për të hyrë në Republikën e Shqipërisë;
- kanë përdorur dokumente të falsifikuara;
- të huajt të kapur me qëndrim të parregullt në territor²⁴.

	2010	2011	2012	2013
Të huajt të parregullt	97	476	1167	1978

Nëse deri në vitin 2010 pjesa më e madhe e shtetasve të huajt të kapur me qëndrim të paligjshëm në territor kanë hyrë në mënyrë të rregullt dhe më pas kanë qëndruar në mënyrë të parregullt, duke tejkaluar afatet kohore të përcaktuara në ligj, në vitet 2011, 2012 dhe 2013, shumica e emigrantëve ta kapur me qëndrim të parregullt në territor kanë hyrë në mënyrë të paligjshme nëpërmjet kufirit tokësor me Greqinë, me qëllim transitimin drejt vendeve të rajonit dhe destinacion final, vendet e BE-së.

Të dhënat për të huajt me qëndrim të parregullt sipas 5 shtetësive kryesore

SHTETËSIA	2010	SHTETËSIA	2011	SHTETËSIA	2012	SHTETËSIA	2013
Turqi	32	Palestinë	197	Algjeri	439	Siria	543
Egjypt	18	Marok	91	Marok	147	Pakistan	394
Palestinë	8	Tunizi	60	Afganistan	126	Eritrea	274
Kinë	7	Algjeri	50	Palestinez	99	Somalia	204
Afganistan	6	Afganistan	34	Tunizi	79	Afganistan	134

Siç shikohet, numrin më të madh e përbëjnë shtetas të cilët vijnë nga vende në konflikt.

Përveç numrit në rritje të shtetasve të huajt të kapur në tentativë për të përdorur territorin tonë si transit drejt vendeve të rajonit me destinacion final vendet e BE-së, shqetësuese për në mbetet fakti i përfshirjes së grupeve kriminale në kontrabandimin apo deri trafikimin e këtyre shtetasve. Në vitin 2013 janë identifikuar 21 raste të dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit, me 29 autorë të përfshirë, ku 16 prej tyre janë arrestuar, 7 janë hetuar në gjendje të lirë dhe 6 të tjerë janë shpallur në kërkim.

²⁴ Të dhënat nga Zyra e Analizës së Riskut dhe Sektori i Ripranimeve në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin
Faqe | 10714



Megjithatë, shifrat e mësipërme flasin qartë se shumica e këtyre shtetasve kanë tentuar të transitojnë vetëm mbi informacion të marrë nga të tjerët apo atë të nxjerrë nga hartat nëpërmjet internetit.

Numri i të huajve të larguar vullnetarisht me urdhër largimi të lëshuar nga autoritetet rajonale për kufirin dhe migracionin:

SHTETËSIA	2010	SHTETËSIA	2011	SHTETËSIA	2012	SHTETËSIA	2013
Turqi	33	Palestinë	139	Pakistan	317	Siri	371
Kinë	7	Kosovë	67	Siri	129	Eritrea	193
Turqi	6	Marok	65	Marok	102	Somali	145
Të tjerat	51	Të tjerat	181	Të tjerat	383	Të tjera	710
TOTALI	97		452		930		1419

Numri i të huajve të kthyer vullnetarisht dhe të asistuar, në vendin e origjinës, sipas shtetësive kryesore

SHTETESIA	2010	SHTETESIA	2011	SHTETESIA	2012	SHTETESIA	2013
Kamerun	1	Nigeria	1	Indi	1		
		Kamerun	1	Bolivi	2		
				Nigeri	1		
TOTALI	1		2		4		0

Numri i të huajve të larguar me urdhër dëbimi

SHTETËSIA	2010	SHTETËSIA	2011	SHTETËSIA	2012	SHTETËSIA	2013
Afganistan	6	Algjeri	45	Algjeri	77	Siri	97
Kinë	11	Afganistan	40	Palestinë	49	Pakistan	68
Egjipt	8	Marok	36	Pakistan	44	Eritrea	25
Të tjerat	12	Të tjerat	115	Të tjera	66	Të tjera	360
TOTALI	36		236		236		559

Nga sa pasqyrohet, numrin më të madh e zënë largimet vullnetare, përkundrejt atyre të largimit me forcë nëpërmjet ndalimit në Qendrën e Mbyllur e më pas dëbimit nga territori.

Numri i të huajve të ndaluar në Qendrën e Mbyllur, sipas shtetësisë

SHTETËSIA	2010	SHTETËSIA	2011	SHTETËSIA	2012	SHTETËSIA	2013
Afganistan	6	Marok	56	Algjeri	114	Siri	97
Egjipt	8	Afganistan	45	Marok	71	Pakistan	68
Brazil	1	Palestinë	41	Siri	51	Somali	37
Palestinë	9	Algjeri	35	Afganistan	48	Eritrea	25
Kamerun	9	Tunizi	22	Palestinë	28	Nigeri	23
TOTALI	40		256		404		331

Përveç rasteve të zbuluara të të huajve me qëndrim të parregullt në territor, një konstatim tjetër ka qenë konstatimi i qëndrimit të tyre të parregullt (si nëpërmjet tejkallimit të afateve të qëndrimit, ashtu dhe hyrjes së paligjshme dhe qëndrimit të paligjshëm) në momentin e daljes së tyre nga Shqipëria, nëpërmjet PKK-ve.

Të dhënat për të huajt e parregullt të konstatuar gjatë daljes në kufi, sipas llojit të shkeljes dhe shtetësisë

Tejkalluar afatin:	2011	2012	2013
Turqi	118	51	17
Itali	84	69	15
Kinë	18	12	
Kroaci	21		
Rumun	21		7
Të tjerë	139	161	30
TOTAL	401	293	69



Numri i të huajve, viktimave të trafikimit të identifikuar

Gjatë viteve 2011, 2012 dhe 2013 ka rezultuar një numër i vogël i rasteve të evidentuara të viktimave të trafikut apo viktimave të mundshme të trafikut.

- Vlerësimi i numrit të të huajve që punojnë ilegalisht

Nga ana e Inspektoratit të Lartë të Punës, strukturë në vartësi të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, si strukturë përgjegjëse në vend për kontrollin e ligjshmërisë në punë, gjatë viti 2011 janë kryer 14 028 kontrolle ku janë evidentuar 145 shtetas të huaj të punësuar pa leje pune përkatëse, në vitin 2012 janë kryer 16 078 kontrolle ku janë evidentuar 203 shtetas të huaj të punësuar pa leje pune, ndërsa në vitin 2013 janë kryer 14 507 kontrolle, ku janë evidentuar vetëm 41 shtetas të huaj pa leje pune.

Bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt", ligji i cili ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2013, nga ana e strukturave rajonale të migracionit janë identifikuar 25 persona të punësuar pa leje pune përkatësisht në 3 kompani, ku janë vendosur masa administrative gjobë në total 12 500 mijë lekë (125 000 \$) ndaj personave dhe 25000 (250 000 \$) ndaj subjekteve të cilat kanë punësuar pa leje pune këta shtetas të huaj.

C.1.3 Rrugët e imigracionit të parregullt, përfshi kondrabandimin

Pozita gjeografike e Shqipërisë, në rrugët migratore kryesisht të vendeve në konflikt, si: Siri, Afganistan, Irak apo vendeve të tjera të Afrikës Veriore apo vendeve arabe, e ka kthyer territorin shqiptar gjatë viteve 2011, 2012 dhe 2013 një ndër segmentet e tentuara nga shtetasit e këtyre vendeve për të emigruar drejt vendeve të BE-së.

Flukset migratore të nisura nga vendet e Lindjes së Mesme, Afrikës Veriore, por jo vetëm, pasi kanë përshkruar vendet, si Turqia dhe Greqia, kanë tentuar të tranzitojnë nëpër territorin shqiptar, me qëllim final vendet e BE-së, kryesisht Itali, Austri, Gjermani, France, Suedi etj.

Pothuajse 99.99% e këtyre emigrantëve të paligjshëm kanë hyrë në territorin shqiptar, nëpërmjet kufirit jugor me Greqinë, përkundrajt 0.1% që kanë hyrë apo kanë tentuar të hyjnë nëpërmjet pikave të kalimit kufitar, kryesisht aeroporti "Nënë Tereza".

Në sajë të një sërë masash të marra nga strukturat e Policisë së Shtetit, falë teknologjisë që po përdorim për survejimin e kufirit nga kamerat termike deri te sistemi i sensorëve të komanduar, falë bashkëpunimit shumë të mirë të të gjitha strukturave, 80% e imigrantëve ilegalë janë kapur sapo kanë hyrë ilegalisht në kufirin shqiptar jugor me Greqinë, përkatësisht në një distancë rreth 1-10 km nga kufiri. Pjesa tjetër, rreth 20% janë kapur ose gjatë transitimit nëpër territorin shqiptar, kryesisht në mjete të transportit publik apo ato private, ose në afërsi të kufirit me Malin e Zi, në tentativë për të dalë ilegalisht nga Shqipëria drejt këtij vendi fqinjë. Në 3 vitet së bashku, 2011, 2012 dhe 2013, janë shënuar vetëm 30 raste të kërkesave për ripranim nga pala malazeze për shtetasit e vendeve të treta, të cilët kishin hyrë apo pretendonin se kishin hyrë në këtë vend nëpërmjet territorit shqiptar, persona të pranuar të gjithë nga pala shqiptare.

Rrugët kryesore të cilat kanë përdorur shtetasit e vendeve të treta kanë qenë:

- Vendi i tyre i origjinës -Turqi – Greqi – Shqipëri.

Kanë preferuar të përdorin territorin e Shqipërisë më shumë ata shtetas të këtyre vendeve që janë gjendur në pjesën e Janinës dhe Igumenicës në Greqi, përkundrajt atyre në pjesën e Selanikut të Greqisë, kjo për shkak të distancës së shkurtër për të përshkruar territorin shqiptar.

Më pas, lëvizjet në territorin shqiptar janë tentuar të kryhen në drejtimet:

- Kakavijë-Gjirokastrë-Tepelenë-Fier-Durrës-Shkodër-Hani Hotit ose Murriqan (kufiri me Malin e Zi);

- Konispol-Sarandë-Himarë-Vlorë-Fier-Durrës-Shkodër-Hani i Hotit/ Murriqan (kufiri me Malin e Zi).

Në disa raste, nga Durrësi, drejtimi i lëvizjes është zhvendosur në Tiranë, për të vazhduar më pas po në drejtim të Shkodrës.

Bazuar në intervistat e të huajve të ndaluar me qëndrim të parregullt, ka rezultuar se rreth 80% e tyre janë deklaruar pranë autoriteteve greke, ku kanë kërkuar azil apo një ndër format e mbrojtjes ndërkombëtare dhe kanë qëndruar në këtë vend nga 1-6 muaj.

Në rreth 50% të rasteve, shtetasve të këtyre vendeve iu janë gjetur dokumente të lëshuara nga autoritetet greke, si leje të përkohshme qëndrimi apo urdhra largimi.

Në një pjesë, rreth 20% të rasteve të tjera, këta shtetas kanë deklaruar se i kishim lënë këto dokumente te të afërm apo të njohur të tyre në Greqi, pasi e dinin se nëse do të kapeshin nga autoritetet shqiptare apo ato të vendete tjera të rajonit, do të ktheheshin prej tyre përsëri në Greqi.


Në të shumtën e rasteve ka rezultuar se shtetasit e etnive të sipërpërmendura lëvizin duke u mbështetur në informacione dhe udhëzimi të marra nga bashkëkombës të tyre, të cilët jetojnë në Greqi ose nëpërmjet informacioneve të marra nga interneti. Në vetëm pak raste këta shtetas janë ndihmuar me informacion nga shtetas shqiptarë, të cilët janë rezident në Greqi. Vitet e fundit janë vërejtur raste të shumta të personave përsëritës, të cilët janë kapur disa herë dhe kthyer në Greqi. Këta shtetas në disa raste janë identifikuar dhe si udhërrëfyes për të kaluar ilegalisht kufirin nga Greqia në Shqipëri, apo për të udhëtuar në brendësi të territorit.

Në territorin e Republikës së Shqipërisë ka rezultuar të hyjnë kryesisht në orët e para të mëngjesit, ose në të errur, në vende jo shumë larg pikave të kalimit kufitar, për të mos humbur orientimin me rrugët automobilistike, si dhe në grupe nga 3-5 vetë, por në disa raste janë kapur dhe në grupe deri në 30 vetë.

Megjithatë janë identifikuar disa raste të këtyre shtetasve të fshehur në kamionë, ku hyrja dhe fshehja është realizuar natën, në territorin grek, gjatë momenteve kur këto mjete kanë qenë në parking.

Gjatë kontrollit personal apo të sendeve personale ka rezultuar se këta shtetas dispononin shuma të vogla monetare, aq sa vetëm për të përshkuar territorin shqiptar. Gjithashtu, në shumicën e rasteve këta shtetas dispononin telefona me numra grekë, në të cilat kryesisht janë gjendur numra të familjarëve apo të afërmeve të tyre në vendet e BE-së. Përveç këtyre, të huajt e ndaluar dispononin harta të printuara nga interneti apo informacion mbi çmimet e shërbimit të transportit publik apo atij taksi jo vetëm për Shqipërinë, por dhe për Malin e Zi dhe Kroacinë.

Karakteristikë është se këta shtetas nuk kanë preferuar të kërkojnë azil apo të qëndrojnë në Shqipëri në momentin kur janë ndalur nga shërbimet e kufirit dhe migracionit, por kanë deklaruar se duan të vazhdojnë rrugën drejt vendeve të BE-së.





C.2 Emigracioni

C.2.1 Numri i përgjithshëm i emigrantëve

Numri i përgjithshëm i emigrantëve i referohet stokut të emigrantëve shqiptarë jashtë vendit.

Emigracioni shqiptar jashtë vendit përbëhet nga emigrantët e ligjshëm jashtë të cilët kanë rregulluar statusin e tyre të qëndrimit, si dhe emigrantët e paligjshëm që gjenden në këto vende.

Megjithëse Shqipëria ka përcaktuar disa rregullime ligjore me anë të ligjit nr. 9668, datë 18.12.2006, "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi" (i ndryshuar), për regjistrimin e shtetasve shqiptar që emigrojnë jashtë për motive punësimi, për shumë arsye sa objektive dhe subjektive ky regjistrim nuk është bërë i mundur.

Meqenëse regjistrimi i shtetasve shqiptarë në regjistër Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nuk është i detyrueshëm, por është mbi baza vullnetare dhe i bazuar në iniciativa lehtësuese të procesit të emigrimit, nga këto struktura, numri i shtetasve shqiptarë që emigrojnë të regjistruar në strukturat e MPÇSSHB-së është shumë i vogël dhe jo përfaqësues i fluksit migrator shqiptar në vite.

SHTETI DESTINACIONIT ²⁵	SHQIPËRIA
TOTALI	1 252 066
AFRIKA	502
AZIA	7 522
EUROPA	1 143 049
Evropa Lindore	2 883
Evropa Veriore	20 294
	Britania e Madhe +Irlanda e Veriut 16 711
Evropa Jugore	1 072 266
	Greqi 574 840
	Itali 449 657
Evropa Perëndimore	47 606
	Gjermani 31 969
AMERIKA LATINE DHE KARAIBET	479
AMERIKA E VERIUT	97 313
	Kanada 12 648
	Shtetet e Bashkuara të Amerikës 84 665
OQEANIA	3 201
Australia dhe Zelanda e Re	3 201

Gjithashtu, as regjistrimi që bëhet për shtetasit shqiptarë kur ata hyjnë dhe dalin nga Republika e Shqipërisë në sistemin TIMS, si dhe as bashkëpunimi i MPJ-së me komunitetet emigratore shqiptare jashtë vendit, nuk kanë mundur të sigurojnë një informacion të saktë në këtë drejtim.

Të dhënat statistikore që vendet e ndryshme publikojnë në agjencitë e tyre kombëtare të statistikave, apo të dhënat e publikuara në EUROSTAT, sigurojnë të dhëna të pjesshme mbi emigrantët shqiptarë në këto vende. P.sh., vetëm sipas të dhënave të INSTAT-it në Itali rezulton se në fund të vitit 2013 gjenden në këtë vend me statusin e rezidentit, 502 546 shtetas shqiptarë.

Bazuar në diferencat mes shumatores së të dhënave të Regjistrimit të Gjendjes Civile dhe Regjistrimit të Huajve me ato të Censurit të vitit 2011, mund të përllogaritet se numri i emigrantëve shqiptarë jashtë vendit të jetë rreth 1 438 874. Megjithatë kjo është një përllogaritje dhe jo shifër zyrtare e deklaruar as nga vendet ku shtetasit shqiptarë janë rezidentë dhe as nga institucionet përgjegjëse shqiptare për menaxhimin e të dhënave statistikore mbi emigrantët.

²⁵ Lista e plotë gjendet në aneksin I.2.5

Ndërkohë, sipas botimit të fundit nga UN, të statistikave mbi emigracionin rezulton se në gjithë botën gjenden përafërsisht 1252 066 shtetas shqiptarë, të ndara në tabelë²⁶:

Përfitimi i të dhënave nga vendet e destinacionit mbi numrin emigrantëve shqiptarë në këto vende do të ishte mënyra më e mirë dhe e saktë e menaxhimit të flukseve emigratore.

Ky Profil i zgjeruar i Migracionit i Shqipërisë nga të dhënat e publikuara mbi imigracionin legal në Shqipëri, ofron të dhëna statistikore mbi emigracionin për të gjitha vendet, shtetasit e të cilave janë rezident në Republikën e Shqipërisë.

C.2.2 Emigracioni sipas motivit

Arsyeja themelore e emigrimit të shtetasve shqiptar është ajo ekonomike. Përveç sa është trajtuar në Profilin e zgjeruar të Migracionit të vitit 2010²⁷, gjatë viteve 2011, 2012 dhe 2013 emigracioni i rregullt nuk ka pasur ndonjë tendencë ndryshe zhvillimi, ndërkohë që emigracioni i parregullt është zhvilluar për dy motive të ndryshme nga sa më parë është përshkruar, favorizuar kjo dhe nga procesi i liberalizimit të vizave për shtetasit shqiptarë; - atë të azilkërkimit në vendet e BE-së; si dhe - atë të braktisjes së fëmijëve me qëllim emigrimi, gjithashtu, në vendet e BE-së.

Mbrojtja nga gjakmarria apo dhe ato të vështirësive ekonomike, kanë qenë motivet e kërkesave për azil të shtetasve shqiptarë në vendet e BE-së.

Shkollimi i fëmijëve dhe, përgjithësisht, siguri i një të ardhmeje më të mirë e më të sigurt për ta, ka qenë motivi i braktisjes së fëmijëve nga prindër shqiptarë pasi kanë mbërritur në vendet e BE-së.

Për sa i përket përbërjes demografike, shoqërore dhe kulturore të emigrantëve shqiptarë, mund të thuhet se:

- në emigracionin shqiptar ka vazhduar të mbizotërojnë moshat e reja (deri në 30 vjeç) dhe mesatare (40-50 vjeç);

- në mënyrë deduktive mund të pohohet që meshkujt përbëjnë pjesën më të madhe të emigracionit;

- prejardhja gjeografike e emigrantëve përfshin të gjitha krahinat e Shqipërisë dhe është e vështirë të përcaktohet nëse ata me prejardhje nga fshati mbizotërojnë mbi elementet me prejardhje qytetare;

- niveli arsimor i shumicës së emigrantëve ka qenë i ulët. Vitet e fundit emigracioni është "ushqyer" me një kontingjent me shkallë më të lartë arsimimi dhe kulture, qoftë për shkak të prurjeve migratore, qoftë për shkak se një pjesë e mirë e studentëve shqiptarë që kanë përfunduar studimet jashtë vendit kanë zgjedhur të qëndrojnë në vendin pritës;

- ndonëse nuk ka të dhëna sistematike dhe të besueshme për punësimin, profesionet që ushtrojnë, statusin ekonomik etj. të emigrantëve shqiptarë, informacioni i disponueshëm dhe vëzhgimet sporadike shtojnë të mendohet se shumica dërrmuese e emigrantëve shqiptarë ushtrojnë profesione që i përkasin punës fizike dhe numri i intelektualëve që ushtrojnë profesionet e tyre është i paktë. Në veçanti, gratë, edhe me arsim të lartë, punojnë në një shkallë të madhe në shtëpitë e vendasve (si: pastruese, bebisiter etj.);

- vitet e fundit, por jo vetëm 2011, 2012 dhe 2013, vihet re një rritje e numrit të shtetasve shqiptarë të vetëpunësuar në biznese të ngritura në vende të BE-së ku ata janë rezident prej shumë vitesh.

C.2.3 Emigracioni i parregullt

Emigracioni i parregullt dhe për vitet 2011, 2012 dhe 2013 ka shënuar rënie të dukshme pothuajse në 300%, në raport me atë të vitit 2010 e më parë.

Krahas masave të marra në përgjithësi nga institucionet përgjegjëse për parandalimin dhe luftën kundër migracionit të parregullt, një rol të rëndësishëm në uljen e këtij emigracioni ka luajtur vetë procesi i liberalizimit të vizave për shtetasit shqiptarë drejt vendeve të BE-së, si dhe me të gjitha vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Emigracioni i parregullt është zhvilluar në dy formate tij:

Së pari, atë të hyrjes në vendet e tjera dhe kryesisht në vendet e BE-së në mënyrë të ligjshme, mundësuar nga lëvizja pa viza dhe më pas keqpërdorimi i kësaj mundësie:

²⁶ <http://esa.un.org/unmigration/TIMSO2013/migrantstocks2013.htm?msdo>

²⁷ www.asp.gov.al "Profil i Zgjeruar i Migracionit të vitit 2010"



- duke kërkuar azil pa arsye;
- duke tejkaluar afatet e qëndrimit;
- duke punuar në mënyrë të parregullt;
- duke përdorur territorin e këtyre vendeve si vende transit për të kaluar në mënyrë ilegale drejt vendeve të tjera, kryesisht Britanisë së Madhe, SHBA-së, Kanada-së, etj;
- duke braktisur me qëllim fëmijët pasi kanë hyrë në vendet e BE-së.

Së dyti, atë të daljes në mënyrë të paligjshme nga kufiri shqiptar drejt vendeve fqinje, kryesisht Greqisë, por dhe vendeve të rajonit Mali i Zi, Kroaci, Slloveni e më pas drejt vendeve të tjera të BE-së, si dhe qëndrimi më pas në vendet e destinacionit (BE) në mënyrë të parregullt. Pjesën më të madhe të këtyre personave e përbejnë ata të cilët e kanë pasur ndalim hyrje në sistemin SIS para vitit 2010, apo iu është ndaluar hyrja në zonën Shengen pas vitit 2010. Një pjesë të vogël të këtyre personave e përbejnë ata të cilët kanë konsumuar afatet 90 ditë në 180 ditë të qëndrimit në zonën Shengen, por kryesisht për qëllime ekonomike kanë tentuar të kalojnë ilegalisht dhe më pas të qëndrojnë në mënyrë të parregullt në këto vende.

Megjithëse, flukset migratore të vendeve të treta me qëllim transitimi nëpërmjet Shqipërisë, kryesisht të ardhur nga Greqia e me destinacion vendet e BE-së kanë pësuar rritje të ndjeshme, ku nga viti 2010 me 97 raste, në 2011 me 476 raste ose rreth 5 herë më shumë, në vitin 2012 me 1167 raste ose rreth 3 herë më shumë se viti 2011 apo 10 herë më shumë se viti 2010 dhe në vitin 2013 me 1978 raste ose rreth 2 herë më shumë se viti 2012 apo rreth 20 herë më shumë se viti 2010, numri i shtetasve të vendeve të treta të kthyer nga vendet e tjera për arsye të kalimit transit në këto vende duke përdorur territorin shqiptar mbeti në shifra tepër të ulëta, rreth 30 në të tria vitet së bashku.

Emigracioni i parregullt është zhvilluar dhe për vitet 2011, 2012 dhe 2013 kryesisht drejt Greqisë, por ndërsa në vitin 2010 përbënte rreth 98% të totalit, në tre vite e fundit ka pasur një rritje të ndjeshme ai i zhvilluar drejt vendeve të tjera të BE-së, si: Gjermani, Itali, Francë, Belgjikë, Suedi, Angli etj.

Tabela e kthimeve sipas grup-moshave dhe gjinisë për 2011- 2013.²⁸

	TOTALI	Meshkuj	Femra	Meshkuj nën 18 vjeç	Femra nën 18 vjeç
2011	15227	14637	590	604	60
2012	14762	14097	665	495	46
2013	20751	20461	290	535	56

Nga sa paraqiten në tabelë e rezulton se rreth 95% e emigrantëve të parregullt të kthyer kanë qenë meshkuj, përkundrajt 5% të gjinisë femër, ndërkohë që në vitin 2013 ky raport është në rreth 98% në favor të gjinisë mashkull.

Ndërkohë, në bazë të një studimi të kryer nga Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT) dhe Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM në vitin 2013 mbi migracionin e kthimit dhe riintegrimin) rezulton se:

Sa i përket kthimit, rezulton që gjithsej 133.544 migrantë shqiptarë të moshës 18 vjeç dhe sipër janë kthyer në Shqipëri në periudhën 2009-2013, prej të cilëve 98.414 meshkuj dhe 35.130 femra. Kjo është një diferencë e madhe në raportin e të kthyerve sipas gjinisë, ku meshkujt janë të mbipërfaqësuar krahasuar me femrat, 73.7 % dhe 26.3% përkatësisht. Që prej vitit 2009 është vënë re një tendencë në rritje e kthimeve, ndërsa shumica e kthimeve kanë ndodhur në vitin 2012 dhe 2013 (53.4 %). Kthimet, ku dominojnë kthimet vullnetare (94 %) kanë ndodhur nga Greqia, 70.8 %, të ndjekura nga Italia me 23.7 % dhe vende të tjera si: Mbretëria e Bashkuar, Gjermania etj. Sa më sipër, mund të argumentohet që kthimet në Shqipëri janë kryesisht pasojë e krizës financiare botërore të vitit 2009 që goditi tregun e punës në vendet kryesore të destinacionit për migrantët shqiptarë. Megjithatë, vrojtimi nuk munda të tregojë nëse kriza ka ndikuar në lëvizshmërinë për punë të migrantëve shqiptarë, përveç mbledhjes së disa të dhënave të kufizuara që mungesa e mundësive për riintegrim në Shqipëri mund të shërbejë si faktor shtytës për riemigrimin e të

²⁸ Shiko tabelat shtesë në aneksin I.2.5 të këtij materiali.

kthyerve.


Arsyet kryesore të kthimit përfshijnë humbjen e punës në vendin e emigracionit, mallin për familjen dhe vendin, si edhe probleme që hasen nga familja në Shqipëri. Arsye të tjera për kthimin përfshijnë mundësi më të mira punësimi në Shqipëri, plane për investim ose probleme shëndetësore. Nuk është vënë re dallim thelbësor gjinor në lidhje me arsyet e kthimit. Këto gjetje konfirmohen edhe nga analiza e të dhënave të mbledhura nga sportelet e migracionit në periudhën korrik 2010 - korrik 2012, si edhe nga gjetjet e studimeve të mëparshme që janë ndërmarrë nga IOM-i.

Shumica e emigrantëve (60.3%) janë kthyer në vendbanimin e tyre të zakonshëm përpara migracionit. Megjithatë vërehet se migracioni i kthimit është i lidhur edhe me migrimin e brendshëm të popullsisë. Tendenca e të kthyerve është që të vendosen në qarqe me zhvillim të lartë socio-ekonomik ku mund të realizojnë planet e tyre të jetës. Tirana është qarku më i preferuar, i ndjekur nga Vlora, Elbasani, Fieri dhe Korça (në rastin e të kthyerve nga Greqia) dhe Shkodra, Lezha, Durrësi dhe Dibra (për të kthyerit nga Italia).²⁹



Mbështetur në analizën e të dhënave të marra nga EUROSTAT dhe pikave të kontaktit në disa nga ambasadat kryesore për çështjet e migracionit situata e shtetasve shqiptarë që kanë kërkuar azil në vendet e BE-së paraqitet si në grafikun më sipër.

Vendet kryesore ku shtetasit shqiptarë kanë kërkuar azil, janë përkatësisht: Gjermania, Greqia, Suedia, Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe Belgjika. E paraqitur grafikisht për periudhën 2011-2013 situata paraqitet si më poshtë:



C.3 Diaspora jashtë vendit

Në Profilin vjetor mbi Migracionin të vitit 2010³⁰, jepet një përmbledhje dhe analizë mbi diasporën shqiptare, historikun e zhvillimit të saj, si dhe gjeografinë e shtrirjes në vende të ndryshme të botës.

Gjatë viteve 2011, 2012 dhe 2013 nuk ka pasur ndonjë zhvillim cilësor as në drejtim të politikave të menaxhimit të diasporës, por dhe as vetë të zhvillimit të diasporës.

²⁹ Të dhënat janë marrë nga një vërtetim kombëtar që u ndërmor nga Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT) dhe Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), si edhe në bazë të të dhënave dytësore të mbledhura nga arkivat dhe dokumentet zyrtare.

³⁰ www.asp.gov.al "Profilin vjetor mbi migracionin për vitin 2010"



Aktivitetet me fokus diasporën më shumë janë fokusuar në drejtim të promovimit të vlerave dhe kulturës shqiptarë në diasporë, si dhe atë të mësimin të gjuhës shqipe te fëmijët në diasporë.

Programi i përbashkët i Kombeve të Bashkuara dhe Qeverisë Shqiptare "Punësimi i të rinjve dhe migracioni: përfitimi i dobive dhe pakësimi i rreziqeve"³¹, lehtësoi kontaktet e drejtpërdrejta ndërmjet përfaqësuesve të qeverisjes qendrore dhe vendore, agjencive të investimeve publike dhe komuniteteve shqiptare jashtë vendit. Pesë konferenca me temë "Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet diasporës shqiptare dhe autoriteteve shqiptare kombëtare dhe vendore për zhvillimin vendor" u organizuan në Londër, Bruksel, Nju-Jork, Athinë dhe Milano nga IOM-i dhe partnerët qeveritarë³² në periudhën 2011 – 2012. Qëllimi ishte rritja e ndërgjegjësimit dhe angazhimi në një dialog për rritjen e kontributeve të diasporës për zhvillimin e vendit, në mënyrë që të parandalohet emigrimi i mëtejshëm i të rinjve dhe në mënyrë të veçantë që të gjenerohet punësim për të rinjtë në zonat e vështira. Përveç sa më sipër, u organizua edhe seminari "Diplomacia ekonomike dhe roli i saj në nxitjen e investimeve të Diasporës Shqiptare për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të vendit" në fazën përmbyllëse të programit, në 4-5 korrik 2012 në Tiranë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga misionet diplomatike shqiptare në vendet kryesore të destinacionit. Seminari synonte identifikimin e mënyrave për të rritur angazhimin e misioneve diplomatike shqiptare në mobilizimin e kontributeve të diasporës për zhvillimin e vendit.

Aktivitetet informuese së bashku me seminarin, mbështetën përpjekjet e institucioneve të qeverisë shqiptare për hartimin e një udhërrëfyese për angazhimin e diasporës shqiptare në çështjet e zhvillimit të vendit. Këto përpjekje mbështeten në bindjen se projekti afatgjatë i ndërtimit të partneriteteve ndërmjet qeverisë dhe diasporës ka më shumë gjasa të ketë sukses nëse bazohet mbi baza të shëndosha të komunikimit të mirë dhe besimit të ndërsjellë. Kjo nënkupton edhe krijimin e një mjedisi mikëpritës për angazhimin e diasporës në aktivitetet e zhvillimit që përfshijnë: përmirësimin e klimës së biznesit në vend, më shumë transparencë në kërkesat dhe rregulloret për licencim, shkëmbimi i shpeshtë i informacionit mbi klimën e biznesit dhe rregullat përkatëse me komunitetet jashtë vendit etj. Si rrjedhojë, mobilizimi dhe angazhimi i grupeve të diasporës shqiptare në nismat e zhvillimit kërkon veprime nga institucionet e qeverisë, agjencitë ndërkombëtare, sektori privat dhe aktorë të tjerë.

C.4 Dërgesat e këmbesave që jetojnë jashtë (remitanca)

Dërgesat e emigrantëve kanë vazhduar të jetë dhe për vitet 2011-2013 një ndër burimet kryesore të ekonomisë shqiptare. Megjithatë, ashtu siç pasqyrohet në tabelën më poshtë, remitancat kanë pësuar në rënie nga viti në vit, referuar vitit 2010. Ndërkohë, monedha vendase ka ruajtur një stabilitet këmbimi përballë monedhave të huaja. Debiti publik ka pësuar rritje të ndjeshme nga viti 2010 e në vazhdim, deri në vitin 2013.

Tabela e kursit mesatar të këmbimit valutor dhe bilancit të pagesave³³

Kursi i këmbimit, mesatare vjetore	2010	2011	2012	2013
ALL/EUR	138.81	138.30	-	140.21
ALL/USD	104.95	105.08	-	102.38
Transferta nga emigrantët (milionë USD)	2010	2011	2012	2013
Remitancat	915	925	868	722
Hyrjet	924	932	875	726
Daljet	-9	-7	-6	-4
Transferta nga emigrantët (milionë EURO)	2010	2011	2012	2013
Remitancat	690	665	675	544

³¹ Programi u financua nga Qeveria Spanjolle përmes Fondit të Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit dhe u zbatua nga ILO, IOM, UNDP dhe UNICEF.

³² Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Punëve të Jashtme, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

³³ Bilanci i Pagesave sipas Bankës së Shqipërisë



Hyrjet	696	670	680	547
Daljet	-7	-5	-5	-3

D. ANALIZA E FAKTORËVE QË NDIKOJNË NË MIGRACIONIN NË VEND

D.1 Karakteristikat kryesore të trendit aktual të imigracionit

Imigracioni i rregullt në Shqipëri gjatë viteve 2011, 2012 dhe 2013 ka arritur në rritje me një tendencë të dukshme për motive punësime.


Krahas rritjes së numrit të përgjithshëm të imigrantëve të rregullt, bie në sy rritja e ndjeshme e shtetasve të BE-së, përkatësisht nga 1572 gjithsej në vitin 2010, në 3293 në vitin 2013, si dhe shtetasve të vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor nga 601 në vitin 2010, në 1032 në vitin 2013. Ndërkohë, shtetasit turq kanë ruajtur pothuajse të njëjta kuota, ndërsa numri i shtetasve kinezë ka pësuar një rënie të lehtë.

Imigrantët në Shqipëri janë të përqendruar në kryeqytet (Tiranë 67%) dhe në qytetet që shtrihen gjatë bregut perëndimor: Durrës (15%), Shkodër (8%), Vlorë (5%).

Lejet e qëndrimit të lëshuara sipas rajoneve (2010-2013)

DRKM	2010	2011	2012	2013
Tiranë	2667	2741	3108	3915
Durrës	614	570	595	440
Shkodër	252	361	370	665
Vlorë	184	394	512	661
Korçë	104	111	163	163
Gjirokastrë	34	35	59	49
Kukës	26	61	63	44
TOTALI	3881	4273	4870	5937

Pozicioni gjeografik i Shqipërisë në itinerarin e rrugëve të flukseve të migracionit të parregullt të vendeve kryesisht në konflikt, ka shënuar një rritje me rreth 20 herë në raport me vitin 2010, të numrit të shtetasve të këtyre vendeve, të cilët kanë tentuar të transitojnë ilegalisht nga Greqia, nëpërmjet territorit shqiptar, drejt vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor, me destinacion final vende të BE-së.



D.2 Faktorët nxitës të migracionit

Ashtu siç migracioni është një fenomen kompleks, shumë dimensionale, në të cilin ndërthuren aspekte sociale, ekonomike, shoqërore, kulturore, politike, juridike etj., faktorët nxitës të migracionit ekzistojnë pikërisht në kompleksitetin e këtyre fushave.

Faktorët nxitës të migracionit përbëhen si nga faktorët shtytës në vendin e origjinës, ashtu dhe nga faktorët tërheqës në vendin e destinacionit.

- Emigracioni ilegal

Faktorët shtytës:

- Disniveli ekonomik i vendi tonë me vendet e zhvilluar të BE-së, dy prej të cilave Italia Greqia që janë vende fqinje, ka vazhduar të jetë dhe gjatë 3 viteve të fundit si faktori kryesor shtytës për shtetasit shqiptarë drejt emigrimit.



- Papunësia dhe pagat e ulëta që ofron biznesi privat në Shqipëri është një faktor tjetër i rëndësishëm i mjedisit që favorizon tendencat emigratore.

- Lëvizja pa viza e mundësuar nga procesi i liberalizimit të vizave në fundin e vitit 2010 për shtetasit shqiptarë, ka shërbyer gjatë këtyre 3 viteve të fundit si faktor jo që ka shtyrë direkt shtetasit për të emigruar, por ka lehtësuar lëvizjen e tyre në emigrim.

Faktorët tërheqës

- Ekziston mbështetja prej më shumë se një milion shqiptarë që jetojnë e punojnë në vendet e BE-së dhe më së shumti në Greqi e Itali për një migracion të vazhdueshëm.

- Niveli i lartë i ekonomisë informale në Greqi ka bërë të mundur punësimin në aktivitetet private të shtetasve shqiptarë të cilët kanë hyrë dhe kanë qëndruar në mënyrë ilegale në Greqi.

- Politika të paqëndrueshme të vendeve të ndryshme të BE-së lidhur me vendosjen apo heqjen e Shqipërisë nga lista e vendeve të sigurta, kushtet "joshëse" nga autoritete e azilit në disa vende të BE-së për shtetasit shqiptarë dhe kur ata kanë kërkuar azil pa ndonjë arsye të provuar, por kanë abuzuar me sistemin e mbrojtjes ndërkombëtare etj., kanë nxitur emigrimin e shtetasve shqiptarë për qëllim azilkërkimi, në vende specifike ku këto politika kanë qenë më favorizuese.

- Imigracioni ilegal

Faktorët shtytës

- Situata jo e qëndrueshme politike, si dhe konfliktet e armatosura në vendet e Lindjes së Mesme dhe nga Afrika ka sjellë valë të reja migratore drejt BE-së gjatë 3 viteve të fundit.

- Grupet e krimit të organizuar duke shfrytëzuar edhe mundësuar udhëtimin, po lehtësojnë transferimin e mijëra emigrantëve të paligjshëm nga këto zona në drejtim Evropës Juglindore dhe më pas në atë të Evropës Qendrore.

- Aktiviteti i shtuar i grupeve terroriste ka nxitur numër në rritje të emigrantëve drejt vendeve të Evropës.

Faktorët tërheqës

- Pozita gjeografike e Shqipërisë, pjesë përbërëse e Evropës Juglindore dhe me kufij tokësorë me Greqinë, Kosovën, Malin e Zi dhe Maqedoni, mund të shihet nga emigrantët e paligjshëm, si një vend transit për në vendet e Bashkimit Evropian të Evropës Qendrore.

- Distanca e shkurtër për të tranzituar nga Greqia deri në Kroaci, si vendi i parë i BE-së, ka tërhequr shtetasit e vendeve të treta për të tranzituar nëpërmjet territorit shqiptar.

- Lidhjet e shumta të emigrantëve të këtyre vendeve në vendet e BE-së, ka ndihmuar në orientimin e tyre drejt të afërmeve të tyre të cilët iu kanë garantuar atyre mbështetje me mbërritjen në këto vende perëndimore.

- Deklarimi i Shqipërisë në mbështetje të Rezolutës së OKB-së për kufij të hapur dhe moskthim të shtetasve në konflikt, ka nxitur shtetasit e këtyre vendeve të transitojnë nëpërmjet territorit shqiptar.

D.3 Trendi i mundshëm i migracionit në të ardhmen

Për arsye të faktorëve demografikë, migracioni mendohet të jetë në rritje, për shkak të plakjes së popullsisë së vendeve të zhvilluara dhe rritjes së saj në vendet në zhvillim.

Projekte të rëndësishme strategjike të cilat pritet të implementohen së shpejti në Shqipëri, siç është projekti TAP apo investime të tjera strategjike në proces apo iniciuar nga investitorë të huaj, mbështetur në politika lehtësuese për disa kategori shtetasish të huaj, ku tashme iu janë mundësuar të drejta të barabarta me shtetasit shqiptarë në tregun e punës, pritet të rrisë ndjeshëm në vitet në vazhdim, numrin e shtetasve të huaj rezidentë për motive punësimi, por dhe të bashkimit familjar.

Nga ana tjetër, me kalimin e viteve numri i emigrantëve shqiptarë në vendet e Evropës Perëndimore dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të ketë prirjen të ulët, sepse një numër gjithnjë e më i madh i tyre do të përfitojë nga procedurat e marrjes së shtetësisë vendase.

Gjithsesi duket se ka një prirje për një integrim më cilësorë në jetën ekonomike. Po kështu, ekziston një numër emigrantësh të cilët tashmë kanë krijuar bizneset e tyre vetjake.

Premisat aspak pozitive në vendet në konflikt apo vende të tjera të Lindjes së Mesme, Afrikës së Veriut dhe në disa vende arabe, nuk premtojnë për ulje të trendit të emigracionit të paligjshëm nga këto



vende drejt vendeve të BE-së, ku Shqipëria, në një pozicion mjaft të favorshëm gjeografik, do të tentohet të jetë pjesë e këtyre rrugëve të emigrimit të paligjshëm të këtyre shtetasve.

E. MODULE SPECIFIKE TË VENDIT ME ÇËSHTJE ME INTERES TË VEÇANTË

Hyrja dhe qëndrimi i të huajve në territorin e Republikës së Shqipërisë është e rregulluar me anë të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt", vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 13.6.2013, si dhe punësimi i tyre me anë të 17 VKM-ve specifike mbi lejet e punës.

I huaji, vetë apo nëpërmjet ftuesit, duhet që brenda 10 ditëve nga hyrja në Republikën e Shqipërisë, apo nga dita e ndryshimit të vendqëndrimit, të regjistrohet pranë autoritetit përgjegjës për kufirin dhe migracionin për vendqëndrimin e tij.

I huaji mund të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë për një periudhë:

- afatshkurtër - 90 ditë/180 ditë, në bazë të vizës së lëshuar apo hyrjes pa vizë;
- të përkohshme - vetëm nëpërmjet pajisjes me leje qëndrimi të përkohshme;
- të përhershme - vetëm nëpërmjet pajisjes me leje qëndrimi të përhershme.

I huaji, i cili, megjithëse plotëson kushtet e qëndrimit, punon në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, konsiderohet se qëndron në mënyrë të paligjshme.

Të huajt, sipas listës në aneksin I.2.6, nuk kanë nevojë të pajisen për vizë për të aplikuar për leje qëndrimi.

Të huajt, sipas listës në aneksin I.2.6, duhet të pajisen me vizë të tipit "D" për të aplikuar për leje qëndrimi, megjithëse ata hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë dhe qëndrojnë 90 ditë për 180 ditë.

Për të aplikuar për vizë, aplikanti duhet të paraqitet personalisht në konsullatë, të paktën kur kryen për herë të parë aplikimin.

Në rast të refuzimit të lëshimit të vizës, i huaji ka të drejtë të riaplikojë vetëm pasi të kenë kaluar tre muaj nga data e marrjes së vendimit për refuzim.

I huaji mund të punësohet në Republikën e Shqipërisë, duke u pajisur:

- me leje pune;
- me certifikatë regjistrimi pune;
- në kushte të barabarta me shtetasit shqiptar (BE/Shengen, Amerikë)

Aplikimi për leje qëndrimi bëhet nga i huaji apo personi i autorizuar prej tij, jo më vonë se 30 ditë pas hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe për ripërsëritjen e saj, jo më vonë se 60 ditë përpara përfundimit të afatit të lejes ekzistuese të qëndrimit. Të huajt të cilët hyjnë pa vizë, por për të aplikuar për leje qëndrimi iu kërkohet vizë e tipit "D", duhet të aplikojnë për leje qëndrimi brenda afatit të tyre të hyrjes 90 ditë nga hyrja e parë, pavarësisht afateve të vizës.

Leja e qëndrimit si person i punësuar jepet në përputhje me lejen e punës dhe me motivin e vizës, me të cilën i huaji ka hyrë në Republikën e Shqipërisë.

Lejet e qëndrimit jepen me afat 3 muaj, 6 muaj dhe 1 vit për herë të parë. Ato mund të përsëriten dy herë radhazi për periudha 2-vjeçare. Pas periudhës 5-vjeçare, pa ndërprerje të lejes së qëndrimit, i huaji mund të pajiset me leje qëndrimi të përhershme.

Për punonjësit me kualifikim të lartë, leja e qëndrimit mund të lëshohet 2 vjet për herë të parë, ripërtërihet për 3 vjet dhe më pas lëshohet leje e përhershme qëndrimi.

Për investitorë të huaj, të cilët investojnë mbi 1 milion euro në Republikën e Shqipërisë dhe punësojnë mbi 10 shtetas shqiptarë, së paku për një vit jepet leje e përhershme qëndrimi për ta, për familjet e tyre dhe personelin kyç që punon për ta.

Shtetasi i huaj mund të aplikojë për shtetësinë shqiptare pasi të ketë qëndruar së paku 5 vite pa ndërprerje me qëndrim të ligjshëm në Shqipëri. Janë të favorizuar aplikantët që kanë kombësi shqiptare dhe kanë pasur prindërit me shtetësi shqiptarë të cilët mund të aplikojnë pas 3 vitesh qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në rastet e bashkimit martesor me një shtetas/shtetase shqiptar, e/i huaji mund të aplikojë për marrjen e shtetësisë shqiptare pas një viti qëndrimi të ligjshëm. Gjithashtu favorizohen në këtë drejtim shtetas të huaj për interesa të veçanta në fushën e shkencës, kulturës, sportit, edukimit. Fëmijët e lindur në Shqipëri nga prindër të huaj marrin automatikisht shtetësinë shqiptare, nëse gjatë regjistrimit kjo kërkohet nga prindërit.

F. POLITIKAT DHE PROGRAMET MIGRATORE DHE EFEKTIVITETI I TYRE NË MENAXHIMIN E MIGRACIONIT DHE SFIDAVE TË ZHVILLIMIT

F.1 Përshkrim i kuadrit institucional kombëtar dhe politika për migracionin

Politika migratore e Republikës së Shqipërisë gjatë viteve 2011, 2012 dhe 2013 nuk ka pasur ndonjë ndryshim në raport me atë të përshkruar në Profillin e Zgjeruar Kombëtar mbi Migracionin të vitit 2010.

Ajo që duhet theksuar është se Shqipëria, pas vitit 2010, vit në të cilin ka përfunduar Strategjia Kombëtare mbi Migracionin, nuk ka pasur një dokument strategjik, ku ndër të tjera të përcaktonte dhe politikën migratore nga vitit 2010 e në vazhdim.

Në kushtet aktuale, kur dinamika dhe problematika migratore shpreh një karakter ndryshe jo vetëm në Shqipëri, por dhe vendet e tjera me ndikim në situatën migratore në vend, në kohën kur Shqipërisë i mungon një politikë e re migratore e shprehur në ndonjë dokument strategjik apo politik të shtetit shqiptar, në kohën kur vetë politika migratore e BE-së është orientuar drejt një partneriteti me Shqipërinë, në kohën kur një sërë nismash më shumë se rajonale, mbi partneritetet për migracionin sapo janë ngritur, ky punim do të shërbejë më së miri që; - i) pas një analize të politikës migratore të BE-së deri tani, por dhe asaj drejt së cilës tashmë BE-ja është orientuar; - ii) pas një analize të fenomenit migrator shqiptar dhe politikës migratore shqiptare në këto 10 vitet e fundit; - iii) të kontribuojë në ngritjen e një platforme të re të politikës migratore shqiptare për të ofruar partneritet në menaxhimin global të migracionit.

Megjithatë, përmirësimi i normatives migratore në frymën e legjislacionit të BE-së në këtë drejtim, mund të konsiderohet si një përmirësim i elementeve përbërëse të politikës migratore, siç janë ato të politikës së dokumenteve të udhëtimit, politikës së vizave, politikës së punësimit, politikës qëndrimit, politikës së ribashkimit familjar, politikës së luftës kundër migracionit të paligjshëm përfshirë këtu hyrjen e paligjshme, qëndrimin e paligjshëm, punësimin e paligjshëm, martesat me qëllim dokumentacioni, përgjegjësitë e transportuesit etj., politikës së kthimit, ripranimeve dhe riintegritit të qëndrueshëm të të kthyerve, politikës së largimeve dhe dëbimeve, politikës së ndalimit dhe aplikimit të masave alternative, politikës së mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të migrantëve dhe mbrojtjes së të dhënave personale, politikës së masave represive dhe ankimit, politikës së integritit të emigrantëve, etj.

F.1. Legjislacion shqiptar mbi migracionin

Legjislacioni shqiptar mbi migracionin përbëhet nga legjislacioni i brendshëm mbi migracionin, si dhe i gjithë kuadri i akteve dy apo shumëpalëshe të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Miratimi i ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt" në 28.3.2013 shënon një përmirësim të mëtejshëm të normativës migratore mbi të huajt, duke e harmonizuar atë tërësisht me legjislacionin e BE-së në këtë fushë, për aq sa Shqipërisë i kërkohet në pozicionin e saj aktual, por dhe perspektivës së afërt në proceset integruese.

Legjislacionin i brendshëm mbi migracionin i cili gjendet i pasqyruar në Profillin e Migracionit të vitit 2010, ka ndryshuar pjesërisht për aq sa lidhet me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për të huajt, si dhe me aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Aktet e tjera nënligjore të cilat nuk janë përfunduar brenda vitit 2013, kanë gjetur zbatim megjithëse ishin nxjerrë në zbatim të ligjit të mëparshëm për të huajt, atë të vitit 2008.

Kështu, përveç ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt", në vitin 2013 pjesë e normativës migratore janë bërë dhe:

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 13.6.2013 "Mbi kriteret për përcaktimin e kriterëve, të përcaktuara e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë".

Përveç përmirësimit të normatives së brendshme migratore, legjislacioni shqiptar mbi migracionin gjatë viteve 2011-2013 është pasuruar nga nënshkrimi i disa akteve të bashkëpunimit me vende fqinje, por dhe të BE-së, si më poshtë:

- Marrëveshje për qarkullimin me kartë identiteti me Kosovën...;
- Marrëveshje për qarkullimin me kartë identiteti me malin e Zi;

- Marrëveshje për qarkullimin me kartë identiteti me Maqedoninë;
- Marrëveshje për shkëmbim të dhënave mbi migracionin e paligjshëm dhe azilin me Britaninë e Madhe;

- Marrëveshje ripranimi dhe protokolli i zbatimit me Moldavinë.

F.1.2 Aktorët institucionalë

Në vijim paraqitet një përshkrim i shkurtër i aktorëve institucionalë kyçë të përfshirë në menaxhimin e migracionit dhe diasporës

- Niveli qeveritar

Në nivel qeveritar nuk ka pasur ndonjë zhvillim lidhur me ngritjen e një strukture koordinuese apo krijimin e një strukture lider mbi migracionin. Struktura të posaçme, në institucione të veçanta shërbejnë si sekretariati për monitorimin e strategjive të ndryshme, të cilat prekin dhe çështje mbi migracionin apo me ndikim mbi migracionin, siç janë Strategjia Antitrafik, Strategjia e MIK, Strategjia e Riintegritit të shtesave shqiptarë të kthyer etj.

- Niveli ndërinstitucional

Në nivelin ndërinstitucional gjithashtu përgjegjësia e institucioneve me menaxhimin e çështjeve migratore ka mbetur e njëjtë si ajo e pasqyruar në Profilin Vjetor mbi Migracionin të vitit 2010.

E veçanta e përgjegjësive institucionale është detajimi i përgjegjësive të autoriteteve përgjegjëse për trajtimin të huajve, të bëra me anë të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt".

- Aktorë të tjerë në fushën e migracionit në vend

Angazhimi i aktorëve ndërkombëtarë në mbështetjen direkt të çështjeve të migracionit në Shqipëri, ka vazhduar në pothuajse të njëjtin intensitet siç gjendet i përshkruar në profilin vjetor të vitit 2010.

Strukturat përgjegjëse shtetërore për menaxhimin e migracionit në Shqipëri, për çështje specifike të menaxhimit të migracionit kanë bashkëpunuar me aktorët ndërkombëtarë, prezenca të të cilëve gjendet në Shqipëri.

Programet e mbështetjes së këtyre aktorëve ndërkombëtarë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse për menaxhimin e migracionit në Shqipëri.

Legjislacioni, teknologjia e informacionit (Registri Elektronik për të Huajt), pajisje dhe teknologji bashkëkohore, trajnime, etj. kanë qenë fushat e mbështetjes direkt të aktorëve ndërkombëtarë në menaxhimin e migracionit.

Vetë hartimi dhe publikimi i këtij Profili të zgjeruar mbi Migracionin është pjesë e mbështetjes dhe konsulencës me aktorët ndërkombëtarë në vend.

F.2 Analizë e çështjeve të koherencës të politikave

Koordinimi politikave

Institucionet përgjegjëse për trajtimin e aspekteve të ndryshme të migracionit në Republikën e Shqipërisë, janë përgjegjëse për implementimin politikave të veçanta migratore, pjesë përbërëse të politikës së përgjithshme migratore sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore, me anë të të cilave është rregulluar normativa migratore në Republikën e Shqipërisë.

Megjithëse nuk ka një strukturë të mirëfilltë në nivel qendror që të koordinojë të gjitha aspektet e politikës migratore, ky koordinimi është mundësuar.

Deri në vitin 2010, kur kishte një Strategji Kombëtare mbi Migracionin dhe një Plan Veprimi, deri në një farë shkalle ishte përcaktuar si përgjegjësia institucionale individuale, si ajo e bashkëpunimit ndërinstitucional, por në një farë mënyre dhe ajo e koordinimit, nëpërmjet llogaridhënies dhe raportimit.

Ndërkohë kur menaxhimi i migracionit është orientuar tashmë të përcaktohet në Strategji të ndryshme sektoriale dhe jo me një Strategji të mirëfilltë Kombëtare mbi Migracionin, çështja e koordinimit në mes disa strukturave të cilat koordinojnë strategji sektoriale, pjesë e të cilave përmbajnë çështje mbi menaxhimin e migracionit, duket pothuajse e pamundur.

Proceset dhe nismat rajonale, apo më të gjera se rajonale mbi migracionin në të cilat Shqipëria është pjesë, kërkojnë një strukturë apo mekanizëm më shumë se Ministria e Punëve të Jashtme, e cila me shumë përfaqëson qëndrimin politik të Shqipërisë në këto nisma së sa atë teknik.



F.3 Bashkëveprimi ndërinstitucional dhe rajonal

F.3.1 Bashkëpunimi ndërinstitucional

Bashkëpunimi ndërinstitucional i strukturave shtetërore përgjegjëse në fushën e migracionit është i parashikuar në strategjitë ekzistuese në fushën e migracionit siç janë Strategjia Kombëtare mbi migracionin dhe Plani i saj i Veprimit (2005-2010), rregullonte deri në një farë shkalle bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave shtetërore përgjegjëse në fushën e migracionit.

Strategjia për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer (2010-2015), rregullon bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave përgjegjëse vetëm për riintegrimin e të kthyerve

Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Kufijve dhe Plani i saj i Veprimit (2008-2013), rregullon bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave përgjegjëse për menaxhimin kryesisht të migracionit të parregullt.

Normativa migratore shqiptare, gjithashtu, përcakton kritere dhe procedura të qarta bashkëpunimi në mes institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e migracionit, por më shumë lidhur me imigracionin, sesa me emigracionin. Kështu p.sh.:

Në fushën e vizave, përveç përcaktimeve ligjore mbi bashkëpunimin ndërinstitucional në këtë aspekt, me anë të udhëzimit të përbashkët të ministrit të Punëve të Jashtme, ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror nr. 2102, datë 3.8.2009, "Mbi bashkëpunimin në mes strukturave të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror për procedurat e lëshimit të vizave", janë përcaktuar qartë jo vetëm aktivitetet e secilës strukturë, por dhe mënyra e bashkëpunimit të tyre, radha e veprimeve, afatet e dërgimit të kërkesës për informacion dhe të kthimit të përgjigjeve, lloji i informacionit që kërkohet, mënyrat e komunikimit etj.

Në fushën e hyrjes dhe të qëndrimit të të huajve, të respektimit të ligjshmërisë dhe afateve të qëndrimit, të largimit të të huajve nga territori etj., përveç përcaktimeve ligjore mbi bashkëpunimin ndërinstitucional në këtë aspekt, me anë të udhëzimit të përbashkët të ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror nr. 2947, datë 6.10.2009, "Mbi bashkëpunimin në mes strukturave të Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror për procedurat e trajtimit të huajve në Republikën e Shqipërisë" është përcaktuar bashkëpunimi i këtyre strukturave në procedurat e përgjithshme të kontrollit në hyrje në Republikën e Shqipërisë, në procedurat për pajisjen me leje qëndrimi të të huajve me qëndrim të ligjshëm, në procedurat e përzgjedhjes së të huajve të parregullt, në procedurat e ripranimit dhe ndalimit në qendrën e mbyllur për të huajt e parregullt, etj.

F.3.2 Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar i Shqipërisë në fushën e migracionit është i gjerë dhe është konkretizuar pothuajse në të gjitha fushat e apo përbërësit e politikës migratore.

Ky bashkëpunim është realizuar si në mënyrë direkte dy apo shumëpalëshe, ashtu dhe në anëtarësimin në nisma të përbashkëta apo bashkëpunimit në nisma të ndryshme rajonale apo me gjerë.

Bashkëpunimi rajonal dhe ai ndërkombëtar është rregulluar me anë të traktateve dhe konventave ndërkombëtare në fushën emigracionit apo atyre specifike me ndikim në çështje të veçanta të migracionit, të njohura nga Republika e Shqipërisë, me anë të marrëveshjeve dhe protokolleve dy ose shumëpalëshe, me anë të memorandumëve të mirëkuptimit, deklaratave të përbashkëta politike në fushën e migracionit, etj.

Përveç akteve ndërkombëtare të përmendura në Profilin Vjetor të Migracionit të vitit 2010, bashkëpunimi ndërkombëtar është mbështetur më tej nga aktet e mëposhtme të nënshkruara dhe njohura gjatë këtyre 3 viteve, si p.sh.:

- Marrëveshje ripranimi

- Protokolli ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Çeke për zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar të 14 prill 2005", nënshkruar më 16 prill 2012, hyrë në fuqi më 1.9.2012.



- Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Moldavisë për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar, nënshkruar nënshkruar, në Bukuresht më 18 tetor 2013.

- Protokollin ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Rumanisë për zbatimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar, nënshkruar në Bukuresht, më 18 tetor 2013.

- Protokollin ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Maltës për zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar, nënshkruar më 27.1.2011, hyrë në fuqi më 31.10.2011.

- Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar, nënshkruar më 6.11.2009, hyrë në fuqi më 17.3.2011.

- Protokollin ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Sllovenisë mbi zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian për ripranimin e personave me qëndrim të paligjshëm, nënshkruar më 20.10.2010, hyrë në fuqi më 3.6.2011.

- Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë mbi ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar dhe protokollin i tij i zbatimit, nënshkruar më 29.4.2011, hyrë në fuqi më 12.10.2011.

- Protokolle zbatimi

- Protokoll i zbatimit logjistik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, nënshkruar më 28.7.2011, hyrë në fuqi më 9.1.2012.

- Protokoll i zbatimit financiar ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, nënshkruar më 30.11.2012, hyrë në fuqi më 1 gusht 2012.

- Marrëveshje për lëvizjen e lirë të shtetasve me kartë identiteti

- Ndryshimi i Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi mbi lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve, nënshkruar më 14.12.2011, hyrë në fuqi më 21.3.2012, me anë të së cilës parashikohet lëvizja e shtetasve të dy palëve me karta identiteti.

- Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për ndryshimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve, nënshkruar më 19 shkurt 2008, nënshkruar më 14.12.2011, hyrë në fuqi më 6.4.2012, me anë të së cilës parashikohet lëvizja e shtetasve të dy palëve me karta identiteti.

- Marrëveshje për shkëmbimin e informacionit për çështje të azilit dhe migrimit

- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Federale Austriake "Për shkëmbimin e ndërsjellë të të dhënave në çështje të kontrollit të migracionit dhe çështje të azilit" nënshkruar në Vjenë, datë 29 janar 2013.

- Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme që operon nëpërmjet Agjencisë së Kufirit të Mbretërisë së Bashkuar për shkëmbimin e informacionit për qëllime që lidhen me migracionin, nënshkruar në Tiranë, 13 mars 2013.

F.4 Vlerësim i përgjithshëm i kontekstit të politikave migratore

Politika bashkëkohore migratore shqiptare zë fill në vitin 1995 me ligjin "Për migracionin", pasuar më pas me ligjet "Për të huajt" dhe formalizuar në vitin 2005 me Strategjinë Kombëtare për Migracionin. Kjo strategji, megjithëse e fokusuar me së shumti në aspektet emigratore për vetë specifikën e situatës migratore në Republikën e Shqipërisë në kohën kur ajo u hartua, shërbeu si platformë e rëndësishme për të orientuar politikën migratore shqiptare drejt asaj të BE-së, si dhe për t'i dhënë zgjidhje çështjeve migratore për periudhën në fjalë 2005-2010.



Hartimi i një dokumenti të ri politik në nivel strategjik mbi migracionin dhe një plani ambicioz Veprimi duhet të shërbejnë si një mundësi e mirë për të përafruar plotësisht politikën shqiptare migratore me atë të BE-së apo të shprehur në normativën dhe rekomandimet e BE-së në këtë fushë.

Migracioni shqiptar, tashmë ka një tjetër dinamikë krahasimisht të ndryshme me periudhën kur u hartua strategjia e parë, lind nevoja që strategjia e re të ketë në fokus jo vetëm parandalimin e migrimit të parregullt nga Shqipëria, por dhe nxitjen e lidhjes migrim-zhvillim. Gjithashtu, është e nevojshme që kjo strategji të trajtojë edhe politikën specifike lidhur me hyrjen, qëndrimin dhe largimin e të huajve nga territori shqiptar.

Politikat në fushën e migracionit në Shqipëri, krahas nevojave të veçanta për menaxhim në përputhje me natyrën specifike të këtij fenomeni në vend, janë të drejtuara edhe nga procesi i integritetit evropian, në kuadër të aspiratës së marrjes së statusit të vendit kandidat dhe më pas atë të anëtarësimit, raport progresive të Komisionit Evropian lidhur me progresin e bërë nga vendi ynë në fushën e migracionit etj.

Një tjetër drejtim i rëndësishëm i politikës migratore për vendin tonë është dhe përmirësimi i politikave të migracionit të punës. Megjithatë liberalizimi i vizave krijon mundësi të lëvizjes së shtetasve shqiptarë pa kufizime shtrënguese si detyrimi për të marrë viza hyrjeje afatshkurtra, ai nuk krijon mundësinë e punësimit të shtetasve shqiptarë në këto vende. Për këtë arsye është e rëndësishme që, nëpërmjet instrumenteve të ndryshme si marrëveshjeve të punësimit, memorandumeve të mirëkuptimit me vendet e BE-së e më tej, të krijohen dhe të rriten mundësitë për shtetasit shqiptarë që dëshirojnë të punojnë në këto vende, për të punuar në mënyrë të rregullt në tregjet e tyre të punës.

G. VLERËSIMI I NDIKIMIT TË MIGRACIONIT DHE POLITIKAVE MIGRATORE NË ZHVILLIMIN SOCIALO-EKONOMIK

G.1 Impakti i emigracionit në zhvillimin social-ekonomik të vendit

G.1.1 Ndikimi në fushën ekonomike

Padyshim që emigracioni ka një ndikim parësor në fushën ekonomike të vendit të origjinës. Kjo është dhe arsyeja që Strategjia Kombëtare e Migracionit 2005-2010 e kishte konsideruar dhe trajtuar migracionin = zhvillim.

Në kuptimin e gjerë, emigracioni ka ndikim direkt pozitiv në fushën ekonomike të vendit si rezultat i dërgesave në para të emigrantëve në vendin e tyre.

Dërgesat e emigrantëve kanë qenë dhe janë shumë të rëndësishme për ekonominë shqiptare në përgjithësi dhe familjet shqiptare në veçanti. Fakti që ato përdoren në mënyrë jo të dobishme nga përfituesit e këtyre dërgesave ka shumë ndikim në kualifikimin e rëndësishëm që ata kanë.

Rritja e importit të mallrave të konsumit, deficitin e madh tregtar gjatë gjithë këtyre viteve të tranzicionit, etj., provojnë përdorimin jo të dobishëm dhe efikas të një pjese të mirë të të ardhurave nga dërgesat e emigrantëve.

Gjithashtu, pjesa më e madhe e dërgesave janë dërgesa sezonale, çka bën që dhe roli dhe rëndësia e tyre në ekonominë e vendit të mos jetë e vazhdueshme dhe e garantuar, por në varësi të sezoneve të punësimit në vendet e destinacionit.

Me gjithë rëndësinë e madhe që kanë dërgesat e emigrantëve në zhvillimin e jetës ekonomike të vendit, çështja shtrohet se sa do të vazhdojë ekonomia të mbahet apo ushqehet nga këto dërgesa. Treguesit e viteve të fundit tregojnë se ka një rënie të ndjeshme në prurjet e këtyre dërgesave në vend. Prandaj, përpara se ekonomia të përballë me një situatë kaq të papërshtatshme, detyra e institucioneve shtetërore është që të marrin masa sesi të nxisin dërgimin e këtyre të ardhurave në vend, por nga ana tjetër të gjejnë forma të tjera për të përfituar nga emigracioni, siç është dhe maksimizimi i përfitimeve direkt nga kthimet e emigrantëve.

Në pamjen e parë duket se ekziston një kontradiktë në mes konceptit të kontributit pozitiv të dy të kundërtave, por në fakt si emigracioni, ashtu dhe kthimi kanë një impakt pozitiv në zhvillimin e ekonomisë së vendit.



Nëse flasim për kthimin e emigrantëve, nënkuptojmë reduktimin dhe të dërgesave në para të tyre nga emigrimi. Kjo do të përbënte impaktin negativ të kthimeve në kuptimin e gjerë të ndikimeve të kthimit në fushën ekonomike.

Nga ana tjetër, kthimi nga emigrimi i shtetasve shqiptarë do shoqërohej me transferimin e aftësive dhe njohurive të marra në vendet e destinacionit.

Punësimi i emigrantëve në ekonomitë e zhvilluara të vendeve pritëse i pajis emigrantët me një kulturë të re të menaxhimit, të njohurive mbi teknikat dhe teknologjitë e fundit, mbi etikën e punës, mbi profesione dhe zanate të munguara në tregun e punës në Shqipëri.

Ajo çfarë shpeshherë i mungon zhvillimit ekonomik të vendit nuk është nevoja për para, nevoja për investime, por aftësia për t'i shndërruar investimet më fitimprurëse apo për të investuar në interes të zhvillimit ekonomie të vendit.

Shumë fusha të ekonomisë në vend sot po mbulohen me shërbime apo thënë ndryshe me fuqi punëtore nga jashtë, pra me fuqi punëtore të siguruar nga imigrimi, jo sepse nuk ekziston fuqi punëtore e lirë në treg, por mungon fuqi punëtore e kualifikuar, nganjëherë dhe për punë jo dhe shumë të veçanta apo të kualifikuara.

Numri i madh i emigrantëve shqiptarë jashtë, shumëllojshmëria e punëve që ata kryejnë, shpërndarja gjeografike e tyre në pothuajse të gjitha vendet e Evropës, por dhe me gjerë, siguron premisa që me anë të kthimit të emigrantëve në Shqipëri të importohet një kontribut me vlerë, i munguar në fuqinë punëtore të kualifikuar shqiptare.

Emigrimi shoqërohet me varfërimin e krahut të punës, pasi shumica e emigrantëve janë relativisht në moshë të re apo në moshën me të përshtatshme për të kontribuar në tregun e punës. Kthimi, ndërkohë, do të sillte në vend fuqinë e re punëtore, aq të nevojshme për zhvillimin ekonomik të vendit.

Emigrantët, në vendin e destinacionit ku ndodhen, në sajë të aktivitetit të tyre, që në rastin e Shqipërisë tashmë nuk është me një emigracion i ri, por i konsoliduar, prej më shumë se 20 vitesh nëse do t'i referohemi vetëm emigracionit pas viteve 1990, në me të shumtën e rasteve kanë krijuar dhe kapitalet e tyre financiare, por dhe në shumë raste kanë ngritur biznese të qëndrueshme në këto vende.

Kthimi i emigrantëve do të sillte automatikisht mundësinë e sjelljes së këtyre investimeve direkt në Shqipëri. Hartimi i politikave nxitëse të kthimit, por dhe të mbështetjes dhe favorizimit të këtyre investimeve do të ishte në fakt politika e maksimizimit të impakteve pozitive të kthimit në fushën e ekonomisë.

Emigrimi i shtetasve shqiptarë jashtë vendit është shoqëruar shpeshherë me pamundësinë e punësimit të tyre në vendet ku kanë emigruar në profesionet e tyre, kryesisht të atyre të kualifikuar në vend. Kthimi i tyre do të sillte njëkohësisht kontributin e kualifikuar të munguar në fusha të ndryshme të ekonomisë.

Një ndër problematikat më të shfaqura vitet e fundit ka qenë largimi i interesit të shtetasve shqiptarë për të punuar në fusha të ekonomisë, si blegtori, bujqësi, etj., si rezultat i mospagesës së mirë në këto fusha, por dhe i etiketimit si "punë të rëndomtë" etj., ndërkohë që në vendet e destinacionit këto lloje punësh kanë qenë ato që kanë zënë përqindjen më të madhe, veçanërisht në Greqi e Itali.

Kthimi i shtetasve shqiptarë nga emigrimi do të shoqërohej me sjellje e një kulture të re për punën, me një angazhim në fushat ekonomike, si bujqësia dhe blegtorja, që në fakt janë dy nga mundësitë më të mira për zhvillimin e ekonomik të vendit.

Kthimi e emigrantëve shqiptarë, së bashku me kapitalet e tyre financiare dhe investuese, nxitja dhe mbështetja e investimeve të tyre direkt në fushën ekonomike të vendit, do të shoqërohej gjithashtu me hapjen e vendeve të reja të punës. Hapja e vendeve të reja të punës do të ulte tendencën për të emigruar të fuqisë punëtore, do të rriste të ardhurat e një numri më të madh të shtetasve, pra do të kishte ndikim direkt në rritjen ekonomike të vendit.

Politika e riintegrit të të kthyerve është një komponent tjetër i rëndësishëm, me anë të të cilit krijohen kushte të favorshme për të kthyerit, për t'u riintegruar në shoqërinë shqiptare dhe për të kontribuar më pas në zhvillimin e kësaj shoqërie.



Në këtë mënyrë, kthimi i emigrantëve është i lidhur me nevojën që shoqëria shqiptare të kontribuojë në riintegrimin tyre dhe nga ana tjetër të kthyerit të kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë shqiptare.

Në kushtet e sotme, kur kriza globale ekonomike ka prekur më së shumti vendet ku kanë emigruar shtetasit shqiptarë, kur dërgesat monetare nga shtetasit shqiptarë kanë pësuar një rënie të konsiderueshme, e gjithë politika ndaj emigracionit duhet të fokusohet ndaj nxitjes dhe më pas mbështetjes së kthimeve me qëllim rritjen e impakteve pozitive nga kthimet.

Nëse emigrantët nuk po ndjejnë më atë klimë të përshtatshme për të punuar dhe jetuar në vendet ku kanë emigruar, ndërkohë që ekonomia vendase në veçanti dhe shoqëria shqiptare në përgjithësi kanë nevojë për këtë kategori, krijimi i klimës së përshtatshme për të kthyerit, madje duke e nxitur dhe mbështetur këtë kthim, do të ishte politika më e drejtë për të garantuar maksimizimin e impakteve pozitive nga kthimet.

Kthimi i trurit do të ishte mundësia më e mirë, kontributi më i madh në maksimizimin e përfitimeve nga kthimi në fushën ekonomike.

Aktualisht, një numër i madh studiuesish shqiptarë, elitë shqiptare e punësuar jashtë vendit, përbëjnë kapacitetin më të madh njerëzor aq të munguar në Shqipëri.

Kthimi i kësaj elite, nëse nga njëra anë konsiderohet shumë e vështirë, politika e nxitjes së kthimit është shumë e thjeshtë: -nxitjen e interesit për t'u kthyer nëpërmjet ofrimit të mundësive për ta që të investojnë kapitalin e tyre, intelektual, profesional, pse jo dhe financiar.

G.1.2 Ndikimet në tregun e punës

Ndikimi i emigracionit në tregun e punës dhe në kushtet kur ky emigracion përbën një përqindje të konsiderueshme në raport me popullsinë dhe kur kategoria e emigrantëve janë 90% pjesa më aktive e tregut të punës mund të veçohet si në aspektin afatshkurtër, ashtu dhe afatgjatë.

Ndikimi i emigracionit në tregun punës duhet parë në kontekst me shkallen e papunësisë në vend, si dhe ritmet e zhvillimit ekonomik të vendit që lidhen me perspektivën e tregut të punës për fuqi punëtore.

Ndërkohë që emigracioni mund të konsiderohet si fenomen negativ në tregun e punës, nga ana tjetër ai ka një ndikim pozitiv në aspektin afatshkurtër, pasi shoqërohet me rënie të papunësisë së popullsisë aktive. Efekti pozitiv i rënies së papunësisë (në mënyrë mekanike për shkak të emigrimit), përveç të tjerash, qëndron dhe në faktin se reduktohen shpenzimet buxhetore për të paguar kategorinë e të papunëve. Megjithatë, në të njëjtën kohë që kemi reduktim të buxhetit për të mbuluar pagesën sociale për të papunët, si pasojë e uljes së numrit të papunësisë nga emigracioni, kemi dhe reduktim të të ardhurave nga taksimi në buxhet, i ardhur për të njëjtën arsye, nga emigracioni.

Përveç emigracionit të mirëfilltë, një ndikim në tregun punës kanë dhe lëvizjet e popullatës nga një zonë në një zonë tjetër të vendit, për motive punësimi, ose i quajtur ndryshe "emigracioni i brendshëm, i cili duhet analizuar në këndvështrimin e ndikimit në tregun punës, së bashku me emigracionin klasik drejt vendeve të tjera të destinacionit.

Nga ana tjetër, "liberalizimi" i tregut të punës për një kategori shtetasish, siç janë të gjithë shtetasit e BE-së, SHBA-së, etj. mundësuar nga ligji nr. 108/2013 "Për të huajt", duket se do të ketë një ndikim negativ në tregun e punës, por në fakt duhet të shihet më optimist, pasi do të sigurojë një fuqi punëtore të kualifikuar, nganjëherë të munguar.

Lehtësirat për investitorët të cilët investojnë mbi 1 milion euro në Shqipëri dhe punësojnë mbi 10 shtetas shqiptarë, së paku për një vit, pritet të kenë impakt pozitiv jo vetëm në fushën e ekonomisë, por dhe atë të tregut të punës.

G.1.3 Ndikimet në demografi

Emigracioni si lëvizje apo zhvendosje e popullatës nga vendi i origjinës në vendin e destinacionit, apo ai i brendshme si lëvizje e popullatës nga një zonë në një zonë tjetër, domosdoshmërisht shoqërohet me ndryshime në demografi.

Analizimi i ndikimeve në demografi i këtyre ndryshimeve për shkak të emigracionit ndihmon për të përcaktuar përshtatjen e politikave të brendshme si në terma afatshkurtër, por dhe afatgjatë, pasi kjo tablo e ndryshimeve pasqyron ndryshimet e momentit, por dhe trendin për të ardhmen.

Në bazë të këtyre ndryshimeve do të ndryshojë dhe planifikimi i zhvillimit të zonave të vendit, orientimi i investimeve, prioritetet, shërbimeve ndaj komunitetit, etj.

Emigracioni ka ndikim jo vetëm në ndryshimin e numrit të popullatës, por dhe të gjinisë, moshës, kualifikimit etj. Nganjëherë prishja e raporteve në mes gjinisë mund të ndikojë në elemente të tjera, si shtimi i popullsisë apo interesi për të qëndruar në një zonë banimi të caktuar.

Ndikimi i emigracionit në demografi mund të shkojë deri në prishjen e balancave rajonale dhe të kërkojë ndryshim (zgjerim apo zvogëlim) të njësive administrative të organizimit të sistemit të qeverisjes vendore.

G.1.4 Ndikimi final

Ndikimi më i rëndësishëm i migracionit konsiderohet në rritjen e remitancave dhe përdorimi i tyre në mënyrë të drejtë në interes të zhvillimit ekonomik të vendit.

Zgjerimi i kanaleve të ligjshme të migracionit do të ketë impakt pozitiv në zhvillimin ekonomik të vendit edhe nëpërmjet zgjerimit të mundësive dhe kanaleve për sjelljen e investimeve direkte të huaja në vend, por dhe të diasporës.

Nxitja e migracionit të ligjshëm nga njëra anë, si dhe lufta kundër migracionit të paligjshëm nga ana tjetër do të plotësonin dy komponentët e domosdoshëm për ta shndërruar migracionin në zhvillim.

Të gjitha së bashku, përveç ndikimit në politikën e brendshme, do të kenë një ndikim direkt në politikën e jashtme, në elementin kyç të saj, atë të integritetit evropian.

G.2 Ndikimet e zhvillimit social-ekonomik në politikat migratore, si dhe format e tjera të ndikimit mbi migracionin

Migracioni është një dukuri e hershme në Shqipëri, ndërsa menaxhimi i migracionit apo politika migratore shqiptare është relativisht e re.

Zhvillimi i politikave migratore në Shqipëri së pari është diktuar nga nevoja e plotësimit të detyrimeve në kuadër të proceseve integruese euro-atlantike të Shqipërisë të nisura këto që nga hapja e negociatave për nënshkrimi i MSA-së, procesin e anëtarësimit në NATO, procesin e liberalizimit të vizave dhe së fundmi atë të plotësimit të kriterëve për anëtarësim të plotë në BE.

Me qëllim harmonizimin e politikës migratore në të gjitha komponentët e saj në përputhje me politikën migratore të BE-së, por dhe të rekomandimeve të BE-së në përgjithësi për vendet që aspironin të anëtarësoheshin në BE dhe të rekomandimeve direkt për Shqipërinë nëpërmjet progres raporteve dhe vlerësimeve të ecurisë së arritjeve të Shqipërisë, del si domosdoshmëri ridimensionim i politikës migratore të Shqipërisë për vitet në vijim e madje deri në anëtarësim në familjen evropiane.

Shqipëria është një vend në të cilin shfaqen të gjitha dukuritë migratore, impaktet e të cilave ndjehen shumë shpejt si në këndvështrimin pozitiv, ashtu dhe atë negativ.

Në këto kushte politika e zhvillimit social-ekonomik e vendit, por dhe politika të tjera si ajo e sigurisë, politika e integritetit, etj. janë të lidhura ngushtë me politikën migratore në mbështetje, por dhe interes të njëra-tjetrës.

H. KONKLUZIONE

H.1 Përfundimet me të rëndësishme në tendencat aktuale të migracionit

Gjatë viteve 2011, 2012 dhe 2013 në Shqipëri, ashtu si dhe në vitet më parë, migracioni është shfaqur, ose ka tentuar të shfaqet në të gjitha format e tij; - në atë të emigracionit (të ligjshëm dhe të paligjshëm), si dhe imigracionit (të ligjshëm dhe të paligjshëm).

Shqipëria gjatë viteve 2011, 2012 dhe 2013 ka qenë vend origjine i emigracionit të ligjshëm dhe të paligjshëm më së shumti drejt vendeve të BE-së, si vend destinacioni i imigracionit të ligjshëm dhe të paligjshëm, si dhe ka tentuar të përdoret dhe si vend transit i migracionit të paligjshëm në përmasa nga 10 -20 herë më shumë se në vitin 2010.

Emigracioni shqiptar (megjithëse shifrat për të nuk janë shumë të sakta) përbën rreth 25-30 % të popullsisë, shifër kjo shumë e lartë, ndërsa imigracioni në Shqipëri përbën vetëm 0.3 % të popullsisë.

Emigracioni i paligjshëm shqiptar drejt vendeve të tjera, e kryesisht drejt vendeve të BE-së në vite 2011, 2012 dhe 2013, megjithëse shënoi një rënie me rreth 3-4 herë, përsëri përbën rreth 0.05% të popullsisë, shifër kjo e lartë.



Procesi i liberalizimit të vizave ka luajtur rol pozitiv në uljen e emigracionit të paligjshëm në përgjithësi, ashtu siç ka favorizuar formën e azilkërkimit dhe atë të braktisjes së fëmijëve nga prindërit në vendet e BE-së.

Lidhur me moshën, për periudhën 2011, 2012 dhe 2013 pjesën më të madhe e përbëjnë të huajt nga mosha 30-50 vjeç.

Për sa i përket gjinisë së shtetasve të huaj rezidentë, vërehet se dhe në vitet 2011, 2012 dhe 2013 vazhdon të dominojë gjinia mashkullore me rreth 70%. Nisur nga statistikatat vërehet një rritje e njëjta përqindje e femrave nga totali i shtetasve të huaj rezident në vitin 2010.

Numri i azilkërkuesve nga shtetas të vendeve në konflikt, megjithëse është rritur pak në vitet 2011, 2012 dhe 2013 në raport me vitin paraardhës 2010, përsëri nuk përbën ndonjë shifër shqetësues (18 raste në 2013). Ndërkohë 140 raste të tjera të azilkërkimit janë mundësuar në kuadër të mbështetjes që Shqipëria i ka bërë kategorive të ndryshme në kampe përqendrimi jashtë Shqipërisë.

Imigracioni i paligjshëm vërehet se ka pasur një rritje në masën 300 % -400% gjatë viteve 2011, 2012 dhe 2013. Kjo ka ardhur si rezultat i shtimit të flukseve migratore nga vendet në konflikt drejt vendeve të BE-së, por dhe si rezultat i përmirësimit të metodologjisë së zbulimit të imigracionit të paligjshëm në territor.

Kriza ekonomike në vendet e BE-së ku me së shumti gjenden emigrantët shqiptarë (Greqi dhe Itali), papunësia e shkaktuar nga kjo krizë, mund të nxisë emigrantët shqiptarë të kthehen në Shqipëri me qëllim investimin e kapitaleve dhe eksperiencave të tyre të fituara tashmë në një emigracion rreth 20-vjeçar.

Klima e favorshme e investimeve të huaja në Shqipëri, angazhimi i qeverisë shqiptare në një numër të madh projektsh, kryesisht në përmirësimin e infrastrukturës së brendshme të transportit dhe energjetikës, ku në zbatimin e tyre janë të angazhuar kompani të huaja, pritet të rrisë në të ardhmen numrin e emigrantëve legalë në Shqipëri.

Situatat e rënduara politike dhe konfliktet e armatosura në vendet e Afrikës Veriore, prezenca e një numri të konsiderueshëm të emigrantëve ilegalë të këtyre vendeve në Greqi, vend fqinjë me Shqipërinë dhe me kufijve tokësorë, pritet të sjellë rritje të konsiderueshme të rasteve të imigrantëve ilegalë të cilët do të tentojnë të përdorin territorin e Republikës së Shqipërisë si vend transit për të kaluar drejt vendeve të tjera të rajonit e destinacion final vendet e ndryshme të Be-së, por dhe për të kërkuar azil si formë të përkohshme qëndrimi dhe mundësie për të vazhduar më pas emigrimin ilegal drejt vendeve të BE-së.

H.2 Përmirësimi i statistikave të migracionit

Menaxhimi i të dhënave mbi migracionin kërkon së pari standardizim në të gjitha proceset e menaxhimit të të dhënave, si atë të grumbullimit, përpunimit, analizimit, shkëmbimit, etj. nga të gjithë aktorët përgjegjës për menaxhimin e migracionit.

Përdorimi i standardeve jo të njëjta në përkufizimin e të dhënave dhe statistikave mbi migracionin, mungesat në mbledhjen e statistikave mbi emigracionin, diasporën, remitancat, por dhe statistikatat e azilkërkuesve shqiptarë jashtë vendit shkaktojnë probleme në menaxhimin në tërësi të të dhënave mbi migracionin.

Publikimi i të dhënave nga institucione apo organizma të paspecializuara, apo publikimi nga ato i të dhënave të pakonfirmuara nga autoritetet përgjegjëse për menaxhimin e tyre, shpeshherë shkakton konfuzion në të kuptuarit e realitetit mbi situatat migratore.

H.3 Rekomandime lidhur me menaxhimin e statistikave mbi migracionit

Në interes të menaxhimit të unifikuar të statistikave mbi migracionin është e rëndësishme që institucionet përgjegjëse për grumbullimin dhe përpunimin e tyre:

- Të standardizojnë të dhënat statistikore mbi migracionin e përputhjen me kërkesat dhe standardet e EUROSTAT.

- Të zhvillojnë sistemet e teknologjisë së informacionit sipas modeleve dhe kërkesave për të prodhuar në mënyrë automatike raporte dhe statistika.



- Të centralizojnë grumbullimin e të dhënave statistikore pranë autoritetit kombëtar përgjegjës për grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave statistikore INSTAT.

- Të kontribuojnë në përgatitjen e profileve kombëtare të zgjuara mbi migracioni së paku një herë në vit, t'i miratojnë ato dhe t'i publikojnë në faqet e internetit të çdo strukture përgjegjëse për menaxhimin e migracionit, duke kontribuar kështu jo vetëm në orientimin politikave të tjera kombëtare të lidhura me migracionin, por duke iu ofruar të gjitha vendet e tjera të dhënat statistikore mbi emigracionin e tyre në Shqipëri. Nëse një gjë e tillë do të bëhet nga të gjitha vendet, atëherë është gjendur zgjidhja e problemit që ekziston pak a shumë në të gjitha vendet; - mungesa e të dhënave statistikore mbi emigracionin.

- Të bashkëpunojnë me partner vendas dhe ndërkombëtar të identifikuar si të angazhuar në çështjet e migracionit me qëllim analizimin e këtyre të dhënave dhe nxjerrjen e rekomandimeve.

- Të përmirësojnë faqet e tyre zyrtare të web dhe t'i pasurojnë ato me të dhëna statistikore mbi migracionin.

I. ANEKSE

I.1 Burimet e përdorura për grumbullimin e të dhënave

1.	Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile
2.	Sistemi i statistikave INSTAT
3.	Regjistri Kombëtar i të Huajve
4.	Sistemi TIMS, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

I.2 Aneke statistikore

I.2.1 Statistika mbi ndryshimet demografike

Popullsia më 1 janar / Population on 1 Januar /000						
Vitet	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Qytet	Fshat	Dendësia
2001	3.060.2	1.525.9	1.534.2	1.293.5	1766.7	106
2002	3.057.0	1.524.5	1.532.6	1.326.8	1730.2	106
2003	3.044.9	1.518.8	1.526.2	1.355.1	1.689.8	106
2004	3.034.2	1.513.8	1.520.5	1.383.1	1.651.1	106
2005	3.019.6	1.506.9	1.512.7	1.410.8	1.608.8	105
2006	3.003.3	1.499.4	1.503.9	1.436.7	1.566.7	105
2007	2.981.8	1.489.3	1.492.4	1.460.7	1.521.0	103
2008	2.958.3	1.477.9	1.480.4	1.484.2	1.474.0	103
2009	2.936.4	1.467.4	1.468.9	1.506.9	1.429.5	102
2010	2.918.7	1.459.6	1.459.0	1.529.9	1.388.8	102
2011	2.907.4	1.455.7	1.451.7	1.552.7	1.354.7	101
2012	2.902.2	1.454.5	1.447.7	1.575.6	1.326.6	101
2013	2.898.8	1.457.3	1.441.5	1.615.8	1.282.9	101

Popullsia sipas grupmoshave më 1 janar

Grupmosha	2011			2012			2013		
	Tot.	M	F	Tot.	M	F	Tot.	M	F
- 15	626.870	326.540	300.330	602.069	313.965	288.104	576.507	300.594	275.913
15-60	1.959.845	976.026	983.819	1.972.880	984.252	988.628	1.985.000	995.163	989.837
60+	320.646	153.104	167.542	327.241	156.257	170.984	337.275	161.575	175.700
Total	2.907.361	1.455.670	1.451.691	2.902.190	1.454.474	1.447.716	2.898.782	1.457.332	1.441.450



I.2.2 Indekset mesatare të çmimeve të konsumit sipas grupeve kryesore

Viti i mëparshëm = 100

Artikulli	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Ushqime dhe pije joalkoolike	100.9	105.9	111.4	116.2	119.0	124.0
Pije alkoolike dhe duhan	100.7	104.2	109.9	122.8	125.6	130.0
Veshje dhe këpucë	96.5	94.6	93.2	91.4	89.4	86.1
Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	103.3	105.1	108.9	111.9	112.9	113.2
Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	100.1	100.5	101.0	101.9	103.3	103.9
Shëndeti	100.8	104.1	111.3	119.9	123.2	122.7
Transporti	104.7	102.5	107.3	113.7	118.6	118.6
Komunikimi	94.4	80.8	81.1	81.3	81.3	81.7
Argëtim dhe kulturë	103.5	110.7	110.9	112.1	114.0	114.7
Shërbimi arsimor	100.3	102.6	105.7	105.8	107.5	109.1
Hotele, kafene dhe restorante	101.0	103.0	104.3	105.6	107.5	109.8
Mallra dhe shërbime të ndryshme	100.4	101.2	102.9	103.2	109.3	108.9
Gjithsej	101.1	103.4	107.1	110.8	113.0	115.2

1.2.3 Statistika mbi punësimin e të huajve

Leje pune të ndara sipas organit lëshues	2011	2012	2013	
			Leje Pune	Vertetim Punesimi
Berat	8	23	14	
Bulqizë	0	24	0	
Delvine	0	0	0	
Devoll	0	1	0	
Dibër	0	0	0	
Durrës	113	128	125	70
Elbasan	117	84	152	
Fier	180	223	159	
Gjirokastrë	10	10	3	
Gramsh	0	1	0	
Has	0	3	3	
Kavajë	3	27	11	
Kolonje	0	0	1	
Korçë	26	17	8	12
Krujë	30	30	20	
Kuçovë	1	1	0	
Kukës	0	1	3	
Kurbin/Laç	10	9	0	
Lezhë	36	34	170	
Librazhd	0	0	0	
Lushnjë	5	5	7	
Malësi e Madhe	2	5	2	
Mallakastër	0	11	3	
Mat	1	0	0	
Mirditë	0	1	0	
Peqin	0	0	0	
Përmet	1	2	1	
Pogradec	11	9	4	
Puke	0	0	0	
Sarandë	4	12	16	
Shkodër	152	67	63	33



Skrapar	0	1	0	
Tepelenë	2	3	1	
Tiranë	1162	1211	1087	386
Tropojë	1	0	1	
Vlorë	47	47	33	26
DPSHKP	378	509	302	242
TOTAL	2300	2499	2189	769

Tabela e kategorizimit të lejeve të punës sipas llojit të aktivitetit ku shtetasit e huaj janë punësuar	2011	2012	2013
Bujqësi, pylltari dhe peshkim	36	27	32
Minierë dhe gurorë	265	301	216
Industria përpunuese (a+b+c+d)	320	351	224
a-Industria ushqimore	11	27	33
b-Industria e tekstileve dhe veshjeve	15	51	29
c-Industria e lëkurëve dhe këpucëve	42	72	34
d -Industri të tjera përpunuese	252	201	128
Elektricitet, gaz, pajisje me rrymë dhe ajër të kondicionuar	27	80	14
Pajisje uji; largim i ujërave të zeza, menaxhim i plehrave dhe aktivitete riparimesh	0	11	0
Ndërtim	281	476	548
Tregti me shumicë dhe pakicë; riparim mjeteve motorike	358	360	265
Transport dhe magazinim	94	51	47
Aktivitetet shërbimi dhe shërbimi ushqimor	33	32	24
Informacion dhe komunikacion	0	141	133
Aktivitetet financiare dhe sigurimesh	59	45	32
Aktivitetet pasurish të patundshme	0	1	5
Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	0	41	49
Aktivitetet administrative dhe shërbimesh mbështetëse	244	35	3
Administratë publike dhe mbrojtje; sigurim social i detyrueshëm	1	2	1
Arsim	146	166	145
Aktivitetet të shëndetit njerëzor dhe punë sociale	93	112	104
Arte, zbavitje dhe çlodhje	0	45	42
Aktivitetet shërbimesh të tjera	100	184	278
Aktivitetet të kryefamiljarëve si punëdhënës; aktivitete prodhuese të mirash dhe shërbimesh të kryefamiljareve për përdorim vetjak	0	1	0
Aktivitetet të organizatave dhe organizmave eks-territoriale	12	37	27
Prodhim	131		
Shuma totale	2300	2499	2189

Tabela e përgjithshme e lejeve të punës sipas shtetësive

Shteti	2011	2021	2013
Amerikë	48	52	17
Angli	30	29	12
Austri	32	33	17
Azerbajxhan	14	0	0
Belgjike	2	0	0
Bosnjë	8	0	0
Brazil	8	7	7
Bullgari	17	12	4
Ceki	10	8	0
Danimarkë	1	0	0
Egjipt	55	26	47
Filipine	50	31	31
Finlandë	1	0	0
Francë	19	28	9
Gjeorgji	1	0	0
Gjermani	23	66	31
Greqi	172	388	139



Holandë	5	17	10
Hungari	20	45	10
Indi	37	17	37
Iran	5	10	11
Itali	243	372	170
Izrael	6	4	8
Japoni	3	0	0
Jordani	0	3	7
Kanada	171	195	156
Kinë	273	188	112
Kore	2	3	4
Kosovë	98	105	165
Kroaci	86	59	33
Kirkistan	1	0	0
Kenia	1	0	0
Letoni	1	1	0
Liban	0	10	11
Mali i Zi	15	10	18
Maqedoni	54	60	65
Marok	1	0	0
Moldavi	5	0	0
Nigeri	12	18	8
Norvegji	4	7	4
Pakistan	3	3	3
Poloni	5	0	0
Rumani	30	28	12
Rusi	4	14	22
Serbi	79	11	15
Siri	15	0	0
Sllovaki	0	1	2
Slloveni	23	11	0
Spanje	4	00	0
Suedi	4	0	0
Tajlandë	0	1	3
Turqi	593	474	865
Tunizi	3	0	1
Ukrainë	0	5	7
Zelandë e re	0	3	3
Zvicër	3	2	3
Të tjera		142	167
Total	2300	2499	2189



Përfitues të lejes së tipit TP sipas shtetësisë dhe vendbanimit

Shteti	2011	2012	2013
Afganistan			1
Argjentinë			2
Australi			1
Austri		5	26
Brazil			9
Bullgari		19	
Ceki			1
Danimarkë		2	
Egjipt	3		
Ekuador			1
Finlandë		1	
Flipine			2
Francë	2	2	
Gjermani	3	6	5
Greqi	2	7	
Holandë	4	2	
Hungari		2	
Indi	1	6	14
Iran	7		
Itali	18	63	26
Japoni		2	4
Jordani		1	
Kanada		1	
Kenia			1
Kine	6	25	18
Kora Jugut			6
Kosovë		3	19
Kroaci	6	1	
Lituani			1
Mali I Zi	1	1	1
Maqedoni	9		2
Mbretëri e Bashkuar	1	6	1
Meksikë			2
Moldavi		1	
Nigeri			1
Paraguai		2	
Poloni	1	2	2
Portugali		2	
Rep. Domenikane			3
Ruandë			1
Rumani		1	
Rusi	1	2	2
Salvador			1
Serbi	1		
SHBA	2	5	4
Siri	1		
Skoci		1	
Sllovaki		1	
Slloveni	3	1	
Spanje	1	5	1
Suedi	1		1
Tanzani			1
Trinidad Tobago			1
Turqi		1	34
Zelanda e re			2
Zvicër		1	1

Vendbanimi	2011	2012	2013
Tiranë	66	104	115
Shkodër		5	47
Elbasan		43	3
Lezha		1	15
Korca		3	2
Dibër		5	2
Berat		1	3
Vlorë		1	4
Lushnjë	7	0	4
Pogradec	1	3	
Polican		0	2
Kavaja		0	1
Kruja		0	1
Puke		6	
Sarande		3	
Laç		1	
Librazhd		4	
Total	74	180	199



I.2.4 Statistika mbi nivelin e edukimit në Shqipëri PUBLIK

Universitete & fakultete	Gjithsej		Sistemi ditës	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Studentë gjithsej	124413	72064	94202	55220
nga këta ndjekin programin:				
Bachelor	95607	53569	70704	39710
1.Universiteti i Tiranës	26618	19346	18550	13870
2.Universiteti Politeknik	7827	2196	7827	2196
3.Universiteti Bujqësor Tiranë	10605	3924	6591	2496
4.Universiteti i Arteve Tiranë	732	276	732	276
5.Universiteti i Sporteve	1011	159	655	86
6.Universiteti "Aleksandër Xhuvani"Elbasan	11058	6943	7282	4825
7.Universiteti "Fan S.Noli" Korçë	6545	3360	4900	2405
8.Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	13319	7761	9789	5870
9.Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	3765	1886	2301	1120
10.Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës	6702	3294	6702	3294
11.Universiteti "Aleksandër Moisiu"Durrës	7425	4424	5375	3272
Master ose tjetër pas Bachelor	26178	17039	23498	15510
1.Universiteti i Tiranës	13893	10485	12330	9385
2.Universiteti Politeknik	3519	1243	3086	1144
3.Universiteti Bujqësor Tiranë	2352	989	1966	849
4.Universiteti i Arteve Tiranë	128	71	128	71
5.Universiteti i Sporteve	230	51	230	51
6.Universiteti "Aleksandër Xhuvani"Elbasan	1640	1226	1457	1105
7.Universiteti "Fan S.Noli" Korçë	703	525	677	502
8.Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	1205	757	1116	711
9.Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	542	340	542	340
10.Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës	1086	767	1086	767
11.Universiteti "Aleksandër Moisiu"Durrës	817	543	817	543
12.Qendra e Studimeve Albanologjike	63	42	63	42
Doktoraturë	2628	1456		
1.Universiteti i Tiranës	1671	999		
2.Universiteti Politeknik	242	94		
3.Universiteti Bujqësor Tiranë	370	177		
4.Universiteti "Fan S.Noli" Korçë	9	3		
5.Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	14	12		
6.Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës	13	7		
7.Universiteti "Aleksandër Moisiu"Durrës	64	41		
8.Qendra e Studimeve Albanologjike	245	123		



PRIVAT

Universitete & fakultete

Gjithsej

Sistemi

			Gjithsej	Femra
Studentë gjithsej			34550	16260
	nga këta ndjekin programin:			
Bachelor			24022	10777
Master ose tjetër pas Bachelor			10528	5483

1.2.5 Statistika mbi migracionin

Shpërndarja e emigrantëve shqiptarë sipas zonave apo vendeve të destinacionit³⁴

Major area, region, country or area of destination	Albania
WORLD	1 252 066
Sub-Saharan Africa	83
AFRICA	502
Northern Africa	419
Egypt	124
Libya	295
Southern Africa	83
South Africa	83
Western Africa	0
ASIA	7 522
South-Eastern Asia	220
Philippines	118
Viet Nam	102
Southern Asia	2 060
Bangladesh	2 060
Western Asia	5 242
Cyprus	327
Jordan	9
Turkey	4 906
EUROPE	1 143 049
Eastern Europe	2 883
Bulgaria	1 195
Czech Republic	308
Hungary	206
Poland	135
Romania	755
Russian Federation	228
Slovakia	56
Northern Europe	20 294
Denmark	312

³⁴ <http://esa.un.org/unmigration/TIMSO2013/migrantstocks2013.htm?msdo>



Finland	236
Iceland	35
Ireland	757
Latvia	8
Lithuania	10
Norway	573
Sweden	1 652
United Kingdom of Great Britain and Northern Ireland	16 711
Southern Europe	1 072 266
Bosnia and Herzegovina	12
Greece	574 840
Italy	449 657
Malta	106
Montenegro	19 775
Portugal	52
San Marino	33
Serbia	266
Slovenia	140
Spain	1 985
The former Yugoslav Republic of Macedonia	25 400
Western Europe	47 606
Austria	2 812
Belgium	3 125
France	6 397
Germany	31 969
Luxembourg	318
Netherlands	1 006
Switzerland	1 979
LATIN AMERICA AND THE CARIBBEAN	479
Caribbean	143
Cuba	114
Dominican Republic	29
Central America	29
Costa Rica	4
Mexico	13
Nicaragua	2
Panama	10
South America	307
Argentina	89
Bolivia (Plurinational State of)	10
Chile	31
Colombia	48
Ecuador	106
Peru	8



Venezuela (Bolivarian Republic of)	15
NORTHERN AMERICA	97 313
Canada	12 648
United States of America	84 665
OCEANIA	3 201
Australia and New Zealand	3 201
Australia	3 063
New Zealand	138

Lista e vendeve me numrin me të madh të kthimit të shtetasve shqiptarë

Shtetet	2011	2012	2013
Austria / Austri	32	160	131
Belgium / Belgjikë	225	292	346
Cyprus / Qipro	0	0	0
Czech Republic / Republika Çeke	0	1	0
Estonia / Estoni	0	0	0
Finland / Finlandë	1	3	13
France / France	225	261	813
Germany / Gjermani	24	306	273
Greece / Greqi	11664	10139	14537
Hungary / Hungari	118	27	2
Ireland / Irlandë	7	10	2
Italy / Itali	1053	1301	1227
Latvia / Letoni	0	1	0
Lithuania / Lituani	0	0	0
Luxemburg / Luksemburg	3	2	7
Malta / Malta	0	0	0
Netherlands / Holandë	70	85	95
Poland / Poloni	0	1	2
Portugal / Portugali	8	5	3
Slovakia / Sllovaki	0	1	2
Slovenia / Slloveni	110	452	397
Spain / Spanje	44	25	38
Sweden / Suedi	33	83	173
United Kingdom / Mbretëria e Bashkuar	349	459	655
Bulgaria/Bullgari	0	0	1
Romania/Rumani	0	1	1
Croatia/Kroaci	35	30	59
Bosnie –Hercegovina/Bosnja	0	0	2
Serbia/Serbi	0	3	0
Macedonia/Maqedoni	276	512	568
Kosovo/Kosova	6	41	88
Montenegro/Mali i Zi	74	61	53
Norway/Norvegji	66	103	137
Denmark/Danimarka	21	39	45
Island/Islanda	0	0	28
Switzerland/Zvicra	453	410	462
Turkiye/Turqi	12	9	8
USA /SHBA	53	36	32
Canada/Kanada	0	69	19
TOTALI	14962	14928	20219



Vendet në krye të listës	2011	2012	2013
Greece / Greqi	11664	10139	14537
Italy / Itali	1053	1301	1227
France / Francë	225	261	813
United Kingdom / Mbretëria e Bashkuar	349	459	655
Switzerland/Zvicër	453	410	462
Belgium / Belgjikë	225	292	346
Germany / Gjermani	247	306	273

I.2.6 Statistika mbi imigracionin në Shqipëri

Numri i imigrantëve në Shqipëri sipas vendit të originës

SHTETI	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Austri	32	31	48	80	87	96	85
Bullgari	22	23	19	28	26	47	42
Finlandë	16	22	15	18	13	12	16
Francë	33	36	48	52	70	78	70
Gjermani	96	105	131	154	200	188	201
Greqi	117	131	145	171	195	360	496
Holandë	43	44	62	72	71	72	85
Itali	608	656	709	827	1065	1277	1553
Kosovë	129	158	220	354	538	577	773
Kroaci	20	32	120	38	88	117	152
Maqedoni	74	143	142	154	198	178	185
Mbretëri e Bashkuar	83	102	115	119	126	148	162
Rumani	31	23	28	44	107	119	120
Rusi	16	15	25	40	52	48	64
Spanjë	12	24	21	25	30	31	34
Turqi	1396	2573	2947	1649	1542	1636	1712
Zvicër	36	36	39	41	52	49	34
Të tjera	130	144	173	248	353	374	379
TOT. Evropa	2894	4298	5007	4114	4813	5407	6163
AZIA							
Filipine	17	20	25	47	79	62	55
Indi	62	58	68	87	79	74	80
Iran	15	18	19	23	29	25	224
Jordani	13	11	11	16	12	13	14
Kinë	276	588	786	387	359	318	298
Kore	42	41	43	63	77	87	85
Pakistan	10	7	9	10	16	14	11
Siri	14	31	31	22	22	41	69
Tajlanda	4	5	5	4	5	4	2
Të tjera	45	41	50	74	97	112	127
TOT.Azia	498	820	1047	733	775	750	965
AMERIKA							
Argjentinë	7	13	14	19	14	10	10
Brazil	25	25	25	30	43	48	59
Kanada	17	28	50	59	144	227	252
Peru	15	7	10	9	10	9	10
SHBA	451	448	447	463	568	643	578
Të tjera	32	36	33	41	39	30	36
TOT.Amerika	547	557	579	621	818	967	945
AFRIKA							
Afrikë e Jugut	10	9	9	9	7	7	18
Egjipt	75	75	87	111	124	133	136
Kenia	7	7	8	12	9	5	6
Nigeri	13	15	16	15	14	24	34
Sudan	10	3	5	5	5	4	4
Të tjera	25	22	27	29	34	38	47
TOT. Afrika	140	131	152	181	193	211	245
Oqania	7	6	8	8	16	18	12
TOTALI	4086	5812	6793	5663	6615	7353	8330



Viza të lëshuara gjatë vitit 2013

Muaji	Miratuar	Refuzuar	TOTAL
Janar	198	13	211
Shkurt	113	25	138
Maras	315	35	350
Prill	168	5	173
Maj	196	12	208
Qershor	177	21	198
Korrik	170	27	197
Gusht	178	27	205
Shtator	198	55	253
Tetor	217	26	243
Nëntor	124	66	190
Dhjetor	146	80	226
Totali	2200	392	2592

Shtetas të huaj që hyjnë pa vizë në Republikën e Shqipërisë

Shtetas të huaj që kanë nevojë për Vize D, për tu pajisur me Leje Qendrimi	Lejohet hyrja me pasaportë	Lejohet hyrja dhe me kartë identiteti
Armeni	x	
Azerbajxhan	x	
Hong Kong, Kinë	x	x
Kazakistan	x	x
Taivan, Kinë	x	
Turqi	x	
Ukrainë	x	
Antigua & Barbuda	x	
Bahamas	x	
Barbado	x	
Brunei	x	
Guatemalë	x	
Honduras	x	
Kosta Rika	x	
Macau, Kinë	x	
Mauritius	x	
Meksikë	x	
Nikaragua	x	
Panama	x	
Paraguai	x	
Salvador	x	
Seychelles	x	
St. Kitts and Nevis	x	
Uruguai	x	
Venezuelë*	x	



Shtetas të huaj që nuk kanë nevojë për Vize D, për tu pajisur me Leje Qendrimi	Lejohet hyrja me pasaportë	Lejohet hyrja dhe me kartë
Andorra	x	
